

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

Tryezë shkencore

22 dhjetor 2015

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SECTION OF SOCIAL SCIENCES

FOREIGN DIRECT INVESTMENTS IN KOSOVA

Scientific conference

22 December 2015

Editor: Correspondent member Jusuf Bajraktari, Secretary of the Section of Social Sciences.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

Tryezë shkencore

22 dhjetor 2015

Redaktor: Anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore.

Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

<i>Editorial: Akademik Isa Mustafa</i> INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË.....	7
<i>Hykmete Bajrami dhe Lulzim Krasniqi</i> RRETHINA E BIZNESIT DHE INVESTIMET E HUAJA DIREKTE.....	13
<i>Fatmir Besimi dhe Rilind Kabashi</i> INVESTIMET E HUAJA DIREKTE – PËRVOJA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.....	31
<i>Bedri Hamza dhe Valentin Toçi</i> INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SEKTORËT BANKARË NË EVROPËN JUGLINDORE DHE NË KOSOVË.....	41
<i>Alban Hashani</i> PROCESI I PRIVATIZIMIT DHE INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË	53
<i>Petrit Gashi</i> MBI NJË ORIENTIM KONCEPTUAL NË POLITIKBËRJE DHE DY MEKANIZMA TË RËNDËSISHËM NË TËRHEQJEN E IHD-VE NË KOSOVË	59
<i>Nazmi Zeqiri dhe Avdullah Hoti</i> TREGU I PUNËS – TËRHEQËS DHE DEKURAJUES I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE.....	71
<i>Artane Rizvanolli</i> TËRHEQJA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE DHE ROLI I KAPITALIT NJERËZOR	79
<i>Arben Mustafa dhe Sokol Havolli</i> RRJEDHA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË KOSOVË.....	87
<i>Bejtush Këçmari</i> PËRCAKTUESIT E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË VENDET E EVROPËS JUGLINDORE.....	95

Editorial: Akademik Isa Mustafa*

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

Në këtë tryezë shkencore do të trajtojmë temën “Investimet e Huaja Direkte në Kosovë” nga shumë dimensione, si për shembull ai i reformës institucionale, i nevojshëm për tërheqje të IHD-së, çështja e riindustrializimit përmes IHD-së, procesi i privatizimit dhe IHD, etj. Tranzicioni është karakterizuar, mes tjerash, me liberalizim të tregjeve për investitorët e jashtëm, me ç’rast është bërë i mundur depërtimi i shumë kompanive në sektorë të ndryshëm të zgjerohen në tregjet e vendeve me ekonomi centraliste.

Liberalizimi i tregjeve, në kuptimin e të ashtuquajturit ‘Konsensusi i Washingtonit’, nuk ishte i mjaftueshëm për të tejkaluar rënien e menjëhershme të outputit dhe krizat e njëpasnjëshme që karakterizuan vendet në tranzicion në fillim të viteve ’90 të shek. të kaluar. Për më tepër, në fazat e hershme liberalizimi ishte burimi i shumë krizave në ekonomi. Ndryshimet në çmimet relative dhe liberalizimi i tregjeve ka krijuar presione konkurruese që çuan në humbje financiare për shumë firma dhe rënie të niveleve të prodhimit. Gjithashtu, subvencionet direkte të ndërmarrjeve u ulën ndjeshëm, duke shkaktuar një rënie fillestare të prodhimit që nuk ka mund të kompensohet nga sektori privat rishtaz i krijuar.

Prodhimi industrial në shumë vende në tranzicion nuk ka arritur atë të nivelit të vitit 1989, përjashtimisht vendeve që zbatuan reformat

* Anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Kryeministër i Republikës së Kosovës. Mendimet e shprehura në këtë editorial nuk duhet të interpretohen si reflektim i pikëpamjeve të institucioneve që përfaqëson autori.

me sukses dhe tani janë anëtare të BE-së. Shpejt u kuptua se krahas liberalizimit të tregjeve u nevojitën institucione të fuqishme dhe funksionale për të mbështetur funksionimin e ekonomive të tregut dhe vendet të përfitojnë nga liberalizimi dhe hapja e ekonomive. Përderisa reformat makroekonomike u zbatuan më lehtë, reformat strukturore si qeverisja, ristrukturimi i ndërmarrjeve, privatizimi, konkurrenca, etj. ishin më sfiduese.

Gjersa ekonomitë e përparuara të Evropës Qendrore, tani anëtare të BE-së, kanë arritur të përfundojnë procesin e transformimit, reformat në vendet e Evropës Juglindore janë vonuar për shkak të luftërave, konflikteve etnike dhe trazirave politike dhe sociale. Kosova ka hyrë në këtë proces relativisht vonë, në vitin 1999, si pasojë e një dekade të regjimit të Milosheviqit dhe luftës.

Pas vitit 1999 edhe Kosova filloi procesin e tranzicionit me përfshirje domethënëse të bashkësisë ndërkombëtare që solli njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të ndërtuar shtyllat themelore të një ekonomie funksionale të tregut. Kështu, u krijuan parakushtet elementare për depërtimin e firmave të huaja edhe në Kosovë. Kosova ndërtoi legjislacionin e ri i cili krijohej në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Rrethina makroekonomike, e dominuar nga sektori privat por edhe nga baza solide fiskale, vazhdimisht ishte në drejtim të përmirësimit, duke reflektuar edhe në treguesit për bërje të biznesit të Bankës Botërore.

Kosova arriti të tërheqë investime në patundshmëri, ndërtim, transport dhe komunikim, shërbime financiare, industri, energjetikë e të ngjashme. Kryesisht këto investime kishin origjinë nga vendet e BE-së, duke filluar nga Gjermania, Austria, Sllovenia, Britania e Madhe, por edhe nga Turqia dhe SHBA-ja.

Kjo tryezë nuk ka synim të jetë gjithëpërfshirëse, por shtjellon çështjen e IHD-së nga disa këndvështrime.

Bajrami dhe Krasniqi trajtojnë temën mbi Rrethinën e Biznesit dhe Investimet e Huaja Direkte. Duke pasur parasysh rëndësinë e institucioneve në performancë ekonomike në përgjithësi dhe IHD-në

në veçanti, Banka Botërore dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në vitet '90 kanë ndërmarrë projekte të rëndësishme në matjen e performancës së institucioneve. Banka Botërore përmes treguesve 'Të bërit biznes' dhe 'Indikatorët e qeverisjes' dhe BERZH përmes një varg treguesish mbi reformën në tranzicion bënë të mundur që vendet të masin dhe krahasojnë performancën e institucioneve relevante për zhvillimin e ekonomisë së tregut.

Besimi dhe Kabashi shtjellojnë përvojat e investimeve të huaja direkte në Republikën e Maqedonisë, që u karakterizuan me disa faza. Prej pavarësisht të Maqedonisë e deri në krizën globale IHD kryesisht bazoheshin në shitjen e ndërmarrjeve shtetërore, sidomos ndërmarrjeve të mëdha ose monopoleve në sektorë strategjikë. Kohët e fundit, përmes zonave të lira ekonomike, IHD fokusohen në sektorë me teknologji më të lartë të prodhimit dhe në vlerën më të lartë të shtuar, kryesisht në sektorët e tregtueshëm si: industri automobilistike dhe industritë shoqëruese, industri kimike, sektori i teknologjisë informatike, procesimi i ushqimit, etj. Ky ndryshim i strukturës së investimeve kishte efekt pozitiv edhe në rritjen e vazhdueshme të eksportit, si dhe në diversifikimin e strukturës së eksportit. Kështu, përvojat e Maqedonisë për tërheqje të IHD-së duhet bartur edhe në Kosovë.

Hamza dhe Toçi në trajtimin e temës së investimeve të huaja direkte në sektorët bankarë në Evropën Juglindore dhe në Kosovë nënvizojnë se reforma e sektorëve bankarë në vendet e tranzicionit ishte një proces i gjatë dhe i vështirë. Mungesa e kësaj reforme implikoi kriza të njëpasnjëshme me kosto të larta fiskale dhe ekonomike. Vetëm pas liberalizimit të këtyre tregjeve për bankat e huaja u arrit funksionimi i sistemeve bankare stabile, konform ekonomisë së tregut dhe në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Përvojat e vendeve tjera ishin të dobishme në themelimin e një sektori të shëndoshë bankar në Kosovë, i dominuar nga investitorët e huaj, me dije dhe teknologji të duhur për banking modern.

Hashani ndërlihdh procesin e privatizimit me IHD-në në Kosovë duke nënvizuar se metoda e privatizimit e përdorur në Kosovë, duke bartur përvojat e mira nga vendet tjera në tranzicion, ka krijuar parakushte të mira për tërheqjen e IHD-ve. Megjithatë, ky proces ka rezultuar me nivele modeste të tërheqjes së IHD-së për shkak të gjendjes së mjedisit afarist të një vendi pas luftës, krahas faktit se shumë ndërmarrje nuk ishin në gjendje të mirë pas shkatërrimeve të viteve të 90-ta të shek. të kaluar. Për më tepër, Kosova ishte bashkangjitur e fundit në garën rajonale për tërheqjen e IHD-ve, përderisa kapacitetet për të bërë një gjë të tillë ishin më të kufizuara.

Gashi në punimin ‘Mbi një riorientim konceptual në politikëbërje dhe dy mekanizma të rëndësishëm në tërheqjen e investimeve të huaja direkte në Kosovë’ diskuton nevojën për një ndryshim konceptual në politikëbërje dhe trajton më në thellësi dy mekanizma determinues të hyrjes dhe të zgjerimit të aktivitetit të kompanive të huaja në Kosovë. Së pari, thekson nevojën e një përfshirje më aktive të shtetit në tërheqjen e investimeve të huaja. Së dyti, nënvizon rëndësinë e dy defekteve strukturore në ekonominë e Kosovës, kualiteti i burimeve njerëzore dhe niveli i performancës institucionale, që, sipas gjykimit, janë pengesë kryesore për investimet e huaja në Kosovë.

Tregu i punës dhe kapitali human konsiderohen shpesh se mund të jenë faktor që ndikojnë në tërheqjen e IHD-ve. Në këtë drejtim, Hoti dhe Zeqiri diskutojnë mbi tregun e punës si faktor tërheqës apo dekurajues, duke konkluduar se fuqia punëtore është faktor që ka ndikuar në tërheqjen e IHD-ve. Në këtë drejtim rekomandohet që të punohet në avancimin e shkathtësive profesionale me qëllim të rritjes së nivelit të IHD-ve.

Megjithatë, po ashtu me metoda empirike për vendet në tranzicion, Rizvanolli shtjellon se si kapitali njerëzor ndikon në tërheqjen e investimeve të huaja. Rezultatet empirike nga vendet në tranzicion përfundojnë duke mos dhënë konkluzione të qarta nëse kapitali njerëzor është faktor që ndikon në tërheqjen e IHD-ve.

Sidoqoftë, autori po ashtu identifikon problemet potenciale në mënyrën e matjes së kapitalit njerëzor dhe matjen e cilësisë së arsimit sa i përket shkathtësive, por edhe kulturës së punës. Në Kosovë në mënyre specifike nuk ka hulumtim empirik për këtë çështje.

Havolli dhe Mustafa në përshkrimin e rrjedhës së investimeve të huaja të drejtpërdrejta në Kosovë paraqesin vlerat e investimeve të huaja të drejtpërdrejta nëpër vite. Është e evidente se viti me normën më të lartë të IHD-së në Kosovë është viti 2007, që rrjedh të jetë edhe si rezultat i investimeve në telekom. Po ashtu, në këtë paraqitje, identifikohet se procesi i privatizimit ka qenë një ndër faktorët që ka ndikuar në hyrjen e IHD-ve gjatë viteve në Kosovë.

Kiçmari analizon empirikisht përcaktuesit e investimeve të huaja direkte në vendet e Evropës Juglindore, duke konstatuar se madhësia e tregut dhe potenciali i rritjes janë treguesit më të rëndësishëm të IHD-ve në EJL. IHD-të, të orientuara kryesisht në sektorin e shërbimeve, determinohen po ashtu nga shkalla e hapjes apo e integritimit me pjesën tjetër të botës dhe privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore ka luajtur një rol të rëndësishëm në tërheqjen e IHD-ve.

Hykmete Bajrami¹ dhe Lulzim Krasniqi²

RRETHINA E BIZNESIT DHE INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Abstrakt

Ky punim analizon faktorët të cilët e përkufizojnë rrethinën e të bërit biznes, duke shpjeguar disa nga determinantet kryesore të cilat ndikojnë në tërheqjen e investimeve të huaja direkte (IHD). Punimi vë në pah se vendet në tranzicion, ku përfshihet edhe Kosova, në mënyrë që të krijojnë kushte të favorshme që ndikojnë në rritjen e fluksit të IHD-ve duhet të kalojnë në një proces të gjerë reformash strukturore, të cilat ndërlidhen jo vetëm me reformimin e resorëve që lidhen drejtpërdrejt me ekonominë, por edhe me përmirësimin e sistemit ligjor dhe funksionimit të sistemit demokratik në përgjithësi. Punimi sjell një përmbledhje të reformave që ka ndërmarrë Kosova sa i përket përmirësimit të rrethit të biznesit, duke konkluduar se, pavarësisht potencialit dhe parakushteve që ofron Kosova për tërheqjen e IHD-ve si dhe përparimeve që janë shënuar në shumë segmente, mbeten

¹ Ligjëruese në Fakultetin Ekonomik (Universiteti i Prishtinës) dhe ministre e Tregtisë dhe Industrisë. Pikëpamjet e shprehura në këtë punim janë të autores dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e institucioneve ku autorja është e angazhuar.

² Këshilltar në Kabinetin e ministres së Tregtisë dhe Industrisë. Pikëpamjet e shprehura në këtë punim janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e institucionit ku autori punon.

ende shumë sfida tjera të cilat duhen tejkaluar në mënyrë që shteti të konsiderohet si lokacion tërheqës për investitorët e huaj.

HJRJE

Investimet e huaja direkte (IHD) përbëjnë një komponent të rëndësishëm dhe me ndikim në rritjen ekonomike të vendeve në zhvillim. Studimet e shumta pohojnë se vendet në tranzicion, në mënyrë që t'u përshtaten rrethanave të reja të ekonomisë së tregut dhe për të rritur nivelin e konkurrueshmërisë së ekonomive të tyre për të operuar suksesshëm në kontekstin e një ekonomie të globalizuar, është dashur të ndërmarrin një varg reformash. Këto reforma nuk janë të kufizuara vetëm në ndryshimin e modelit ekonomik, por nënkuptojnë transformim rrënjësor institucional. Për të përballuar këto sfida transformuese, vendet në tranzicion janë ballafaquar me mungesë të potencialit të nevojshëm për të financuar projektet që kanë të bëjnë me ristrukturimin e ndërmarrjeve, përmirësimin e infrastrukturës, reformimin e administratës dhe konsolidimin e institucioneve demokratike. Në këtë kontekst IHD-të kanë marrë rolin e një burimi domethënës në procesin e transformimit ekonomik dhe institucional të shteteve në tranzicion. Për më shumë, përveç efektit pozitiv që IHD-të japin si kapital i freskët i ardhur nga jashtë, ato sjellin me vete edhe efekte të shumëfishta pozitive për ekonominë e vendeve pritëse. Duke e ditur që shumica e IHD-ve vijnë nga vendet e zhvilluara, ekziston një konsensus i gjerë i studiuesve të cilët pohojnë se përmes tyre bëhet edhe transferi i teknologjisë, i informacionit, i kulturës së punës dhe asaj menaxheriale, si dhe i njohurive bashkëkohore rreth marketingut dhe shitjes (shih, p.sh., Cooper, 2001; Bisson, 2012). Për më shumë, IHD-të ndikojnë pozitivisht edhe në ngritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve dhe rrjedhimisht rritjes së kapacitetit eksportues të vendit dhe përmirësimin të bilancit tregtar (shih, përveç tjerësh, Ghosh dhe Wang, 2009; Benassy-Quere, Coupet dhe Mayer, 2007).

Duke marrë parasysh këtë që u tha, e konfirmuar edhe nga hulumtimet e shumta empirike të cilat pohojnë se IHD-të kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike për vendet në zhvillim (Ghosh dhe Wang, 2009), qeveritë e shteteve të cilat e kanë në qendër të vëmendjes së programeve të tyre qeverisëse zhvillimin ekonomik bëjnë përpjekje të shumta për të krijuar rrethinë të përshtatshme për të bërit biznes. Këto angazhime duhet të jenë të vazhdueshme dhe konsistente në mënyrë që shteti të jetë në vazhdimësi konkurrues, krahas vendeve tjera të cilat e bëjnë të njëjtën gjë. Këto lloj përpjekjesh të qeverive të ndryshme i bëjnë ato jenë në konkurrencë të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën për të qenë sa më atraktive për tërheqjen e IHD-ve (Rose-Ackerman, 2004).

Për të arritur sukses në përmbushjen e këtij synimi, vendi pritës duhet të ndër marrë një sërë reformash të rëndësishme strukturore. Për këtë qëllim, shumë shtete e kanë përfshirë objektivin për përmirësimin e rrethinës së biznesit në kuadër të strategjisë së tyre kombëtare për zhvillim ekonomik (World Bank, 2005). Përmirësimi i rrethinës së të bërit biznes nënkupton një transformim shumëdimensional për vendet në tranzicion, ku përfshihen, ashtu siç do të shpjegohet më poshtë, një varg i gjerë faktorësh që duhen reformuar e të cilët kanë ndikim në tërë spektrin e zhvillimit të aktivitetit afarist dhe funksionalitetit institucional të vendit.

Punimi është i organizuar si vijon: Përveç hyrjes, e cila nënvizoi rëndësisë së IHD-ve për vendet në tranzicion, seksioni i parë jep një shpjegim të kornizës teorike sa i përket rrethinës së biznesit dhe ndër lidhjes së saj me tërheqjen e IHD-ve, duke shpjeguar disa nga determinantet kryesore. Seksioni i dytë merret me analizimin e rrethinës së biznesit në Kosovë, duke shpjeguar përpjekjet që janë bërë nga institucionet e vendit në përmirësimin e rrethinës së biznesit. Pjesa e fundit sjell konkluzionet, duke nënvizuar, përveç arritjeve edhe sfidat që Kosova duhet adresuar në mënyrë që procesi i

reformave për krijimin e një mjedisi optimal për të bërit biznes të sjellë rezultate pozitive në tërheqjen e IHD-ve.

SHPJEGIM I KORNIZËS TEORIKE TË RRETHINËS SË BIZNESIT DHE FAKTORËT MOTIVUES PËR TËRHEQJEN E IHD-SË

Ekzistojnë disa kategorizime teorike sa i përket motivimit të kompanive ndërkombëtare për të investuar në vende të ndryshme. Njëra nga to, e cila ka një përdorim të gjerë, është kategorizimi i IHD-ve në: IHD horizontale dhe vertikale (shih, p.sh., Markusen, 1995; Dunning, 1993; Markusen dhe Venables, 1999). IHD horizontale (market-seeking FDI) quhen ato investime të cilat vijnë me qëllim primar të kërkimit të tregut në vendin pritës. Motivët në bazë të të cilave kompanitë e huaja vendosin të investojnë në një vend tjetër, në bazë të këtij modeli, është që ato t'u afrohen (përmes hapjes së filialave) sa më shumë konsumatorëve të tyre në tregun e vendit pritës duke u pozicionuar më mirë përballë konkurrentëve të tyre lokalë që operojnë në po të njëjtin treg (Markusen, 1995). Tregjet e vogla dhe me fuqi të ulët blerëse tradicionalisht kanë pasur më pak gjasa të tërheqin këtë lloj të investimeve. Megjithatë, sot kur tregjet e vogla, si ky i yni, po integrohen në kuadër të atyre të mëdha përmes marrëveshjeve të tregtisë së lirë (CEFTA, MSA, etj.), këto investime janë të pritshme.

Në anën tjetër, IHD vertikale (resource-seeking FDI) quhen ato investime kur kompanitë investojnë në një vend të huaj për shkak të resurseve të cilat i posedon vendi pritës (p.sh. mineralet, lënda e parë, etj.). Motivim shtesë për këtë lloj investimi janë edhe përparësitë tjera që ndikojnë në uljen e kostove operative të investitorëve në vendin pritës, si p.sh. fuqia e lirë e punës (Dunning, 1993). Këto lloje investimesh janë të larta në aspektin kuantitativ dhe ndikojnë në rritjen e kapacitetit eksportues të vendit pritës. Mirëpo duhet pasur kujdes që qeveria e vendit pritës para se t'i jep në shfrytëzim resurset e veta të

nxjerr përfitime të mira (në aspektin financiar, teknologjik apo mjedisor) që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve.

Lloji tjetër i IHD-ve është ai i bazuar në efikasitet (efficiency-seeking FDI). Motivimi prapa këtyre investimeve është që kompanitë të racionalizojnë resurset e tyre duke u shpërndarë në tregje strategjike për të mbuluar sa më mirë klientelën, gjë e cila e rrit efikasitetin e tyre si dhe ua redukton kostot. Në këto raste “kompanitë investuese përfitojnë nga dallimet me të cilat karakterizohen tregjet e ndryshme në një regjion të caktuar ku përfshihen edhe dallimi i çmimeve, niveli i ndryshëm i zhvillimit ekonomik të shteteve, dallimet në shijet dhe preferencat e konsumatorëve, si dhe aftësitë furnizuese” (Dunning, 1993, 58).

Mund të thuhet se ende nuk ka një kornizë teorike dominuese e cila shpjegon motivimin e investimeve të huaja direkte, prandaj autorë të ndryshëm përdorin teori të ndryshme. Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se përpjekjet rreth analizimit të IHD-ve janë intensifikuar paralelisht me rritjen enorme të investimeve të huaja direkte në vendet në tranzicion gjatë dy-tri dekadave të fundit dhe ato bazohen kryesisht në hulumtimet empirike, duke matur faktorët apo determinantet veç e veç, si dhe specifikat politike, ekonomike dhe sociokulturore të vendeve pritëse.

Më poshtë do të shpjegojmë disa nga faktorët kryesorë të cilët e përkufizojnë rrethinën e të bërit biznes dhe që ndikojnë drejtpërdrejt në motivimin e investitorëve për të sjellë kapitalin e tyre në vendin pritës.

Sipas World Investment Report, determinantet e IHD-ve janë kategorizuar në tri grupe kryesore, ku përfshihen: faktorët politikë, faktorët ekonomikë dhe faktorët e lehtësimit të biznesit (UNCTAD, 1998). Kur jemi te faktorët politikë, ndër më të rëndësishmit është i ashtuquajtur ‘faktori institucional’, i cili e mban barrën kryesore të

adresimit të shumicës së aspekteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e rrethinës së të bërit biznes në një vend. Siç dihet, vendet në tranzicion janë ballafaquar me probleme të shumta në procesin e transformimit të tyre si shoqëri demokratike dhe me ekonomi të tregut të lirë. Në këtë kontekst, disa nga barrierat kryesore të cilat shihen si frenuese në tërheqjen e IHD-ve janë: mungesa e sundimit të ligjit, jostabiliteti politik i përcjellur me trazira dhe dhunë politike, niveli i lartë i korrupsionit, joefikasiteti i administratës, mungesa e transparencës dhe llogaridhënies, mungesa e lirisë së shprehjes, shkelja e të drejtave të njeriut, etj. (Bisson, 2012; Schneider dhe Matei, 2010). Në këtë mes investitorët e shohin me vëmendje komponentën e quajtur ‘kualiteti i institucioneve’³ apo qeverisja e mirë, përkatësisht faktin se sa janë të afta institucionet e vendit pritës për t’i eliminuar këto barrierë. Sepse, p.sh. në një vend me shkallë të lartë të korrupsionit gjasat për ardhjen e investitorëve të huaj janë shumë të limituara për shkak se operimi i kompanive në ambiente të tilla e rrit rrezikshmërinë dhe e bën më të shtrenjtë koston operative (Xu, 2010). Sipas, Wei (2000), mungesa e ‘kualitetit institucional’ ku korrupsioni dhe zhvatja janë mënyrë e punës e shërbyesve civilë, që krijojnë atë që quhet ‘klimë e mosbesimit’ e cila i mban larg investitorët e huaj. Përveç korrupsionit, i rëndësishëm është edhe stabiliteti politik afatgjatë dhe funksionimi demokratik i institucioneve dhe kjo ka ndikim tek investitorët të cilët nuk dëshirojnë të operojnë në shtete me ambient jostabil politik (Rose-Ackerman, 2004). Stabiliteti afatgjatë politik dhe institucional sigurojnë koherencë të politikave ekonomike dhe garantim të sundimit të ligjit që është komponent jetik për investitorët. Studimet e shumta tregojnë se sa më i vogël të jetë rreziku politik në vend, aq më i lartë është fluksi i IHD-ve (Schneider dhe Matei, 2010). Prandaj mund të thuhet se institucionet e qëndrueshme dhe demokratike janë vitale për një shtet në mënyrë që

³ Shih, Barrell dhe Pain, 1999; Busse dhe Hefeker, 2007; Ali, Fiess dhe Mac Donald, 2010.

ai të shihet si destinacion serioz për investime të huaja direkte nga kompanitë ndërkombëtare.⁴

Faktorë tjerë të cilët e karakterizojnë rrethinën e të bërit biznes, e që ndikojnë në motivimin apo jo të tërheqjes së IHD-ve, janë faktorët ekonomikë. Në këtë mes ekziston një listë e gjatë syresh rëndësia e të cilëve dallon nga shteti në shtet apo nga vetë këndvështrimi i studiuesve dhe i investitorëve. Për shembull, Bisson (2012) thekson se mungesa e infrastrukturës dhe e kapitalit njerëzor të kualifikuar e pengon shumë fluksin e IHD-ve. Banka Botërore (1997) i jep rëndësi më të madhe nevojës për një mjedis stabil makroekonomik dhe për kapacitete të mjaftueshme për menaxhimin e çështjeve ekonomike. Kapitali njerëzor, infrastruktura fizike (rrugët, hekurudhat, energjia elektrike, telekomunikacioni), infrastruktura e inovacionit, stabiliteti makroekonomik, sistemi bankar, liberalizimi i tregut, madhësia e tregut, tregtia ndërkufitare, niveli i të ardhurave për kokë banori, shkalla e rritjes ekonomike, struktura e tregut të vendit pritës, qasja në tregjet rajonale dhe globale, çmimi i lëndëve të para etj. janë të gjithë faktorë të rëndësishëm ekonomikë, specifikat dhe niveli zhvillimor i të cilëve merret për bazë nga investitorët në procesin e vendimmarrjes së tyre se në cilin vend të investojnë (Dunning, 2004).

Përveç faktorëve politikë dhe ekonomikë, ndikim tejet pozitiv në tërheqjen e IHD-ve kanë edhe politikat nxitëse të shteteve pritëse apo faktorët e lehtësimit të biznesit, ku qeveritë e shteteve, me qëllim të tërheqjes së IHD-ve krijojnë lehtësira të shumta për bizneset sikurse: politikat fiskale, lehtësimet e ndryshme tatimore, zonat ekonomike, lirimet doganore, dhënia në shfrytëzim e aseteve, subvencionet dhe skemat e ndryshme financuese, etj.

⁴ Për një analizë më të zgjeruar rreth rëndësisë së institucioneve politike, stabilitetit qeverisës dhe demokratik ku përfshihen edhe zgjedhjet e lira dhe rreziku politik, shih, p.sh., Busse dhe Hefeker 2007; Biglaiser dhe Garland, 2009; Anghnel, 2005; Wernick, Haar dhe Singh, 2009.

RRETHINA E BIZNESIT NË KOSOVË

2.1. Parakushtet për tërheqjen e IHD-ve

Studimet e shumta theksojnë se secili vend ka karakteristika të veçanta sa i përket mundësive për bërje biznes, ku përfshihen përparësitë dhe disavantazhet. Për dallim nga shumë shtete tjera evropiane në tranzicion, Kosova është ballafaquar jo vetëm me procesin sfidues të tranzicionit, por edhe me atë të riparimit të dëmeve shumëdimensionale të shkaktuara si pasojë e luftës. Kjo veçanti ka pasur ndikim edhe në aspektin e rrethinës së të bërit biznes, përkatësisht mënyrës, shpeshherë paragjykuese, se si investitorët e huaj e kanë parë Kosovën si lokacion për investime. Në këtë kontekst Kosova ka pasur detyra shtesë që të punojë në mënjanimin e asaj që quhet ‘distançë psikologjike’ nga investitorët e jashtëm e krijuar nga historiku i gjatë i paraqitjes së vendit tonë si arenë konflikti e jostabiliteti politik dhe jo si mundësi për afarizëm. Për të eliminuar këtë pengesë vendi duhet të punojë me këmbëngulje, përveç tjerash, edhe në promovimin para kompanive ndërkombëtare të rezultateve pozitive të arritura në procesin e përmirësimit të ambientit të të bërit biznes.

Kosova ka mjaft parakushte dhe karakteristika favorizuese sa i përket rritjes së fluksit të investimeve të huaja direkte. Viteve të fundit Kosova ka arritur të krijojë qasje të lirë në tregjet e rajonit përmes marrëveshjes për tregti të lirë (CEFTA)⁵ dhe së voni edhe në tregun e Bashkimit Evropian, përmes Marrëveshjes për Stabilizim Asocimit (MSA).⁶ Integrimi në këto tregje ndihmon që kompanitë e huaja të mos e shohin Kosovën si një treg të vogël, por si përparësi, që, duke shfrytëzuar fuqinë e lirë të punës, të zhvillojnë aktivitet prodhues me

⁵ Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Evropën Qendrore, e cila përfshin 7 vende jone-tare të BE-së: Shqipërinë, Bosnjen e Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi, Moldavinë dhe Serbinë.

⁶ Kosova është pjesë edhe e Programit të Sistemit të Gjeneralizuar të Preferencave me SHBA-të, Japoninë dhe Norvegjinë, si dhe ka nënshkruar Marrëveshjen për tregti të lirë me Turqinë, e cila pritet të ratifikohet.

destinacion tregjet e mëdha. Sa i përket ndërveprimit ekonomik të Kosovës me këto tregje, mund të thuhet se përkundër vështirësive të pritshme gjatë një periudhe fillestare - ku kompanitë nga vendi duhet të përballen me sfidat e konkurrencës karshi firmave më të fuqishme dhe me përvojë nga jashtë -, në planin afatmesëm dhe atë afatgjatë, ashtu siç është dëshmuar edhe me ekonomitë e vendeve të Evropës Qendrore (p.sh. Hungaria, Republika Çeke dhe Sllovakia), efektet do të jenë pozitive për ndërmarrësit dhe ekonominë e vendit.

Përveç plotësimit të një komponenteje të rëndësishme, sikurse të qenit pjesë e tregjeve të mëdha, Kosova ka mjaft parakushte tjera të cilat mund të motivojnë ardhjen e investitorëve të huaj në vend, si p.sh. resurset e konsiderueshme nëntokësore, kapitali njerëzor, asetet e mbetura nga procesi i privatizimit, si dhe shumë sektorë të tjerë.

2.2. Reformat e ndërmarra nga institucionet e Kosovës për përmirësimin e rrethinës së biznesit dhe nxitjen e investimeve

Si rezultat i konsolidimit të faktorit institucional dhe duke e njohur rëndësinë e IHD-ve për ekonominë e vendit gjatë viteve të fundit, Kosova ka punuar më me intensitet në përmirësimin e rrethinës së të bërit biznes dhe nxitjes së aktivitetit ekonomik, me ç'rast janë bërë përparime në përmirësimin e shumë determinantave të cilat bien në domenin e tre faktorëve kryesorë të përmendur më lart (faktorët politikë, ekonomikë dhe faktorët e lehtësimit të biznesit). Është punuar dhe po punohet në ndërtimin e një sistemi ligjor, i cili është në përputhshmëri me legjislacionin e BE-së, ku bën pjesë edhe Ligji për investimet e huaja, i cili siguron trajtim të barabartë për investitorët e jashtëm dhe ata vendorë; është bërë nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale me një numër të shteteve për mbrojtjen dhe promovimin e investimeve si dhe për shmangien e tatimit të dyfishtë.⁷ Në fushën e reformave fiskale dhe instrumenteve nxitëse për promovimin e

⁷ Këto marrëveshje sigurojnë: mbrojtje dhe siguri, transfer të lirë të fondeve, riatdhesim të lirë të profitit dhe dividendës, mbrojtje nga aplikimi retroaktiv i ligjeve, mbrojtje nga shpronësimi.

investimeve janë shënuar disa rezultate pozitive të cilat ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes. P.sh: nga 1 shtatori 2015 ka hyrë në fuqi pakoja e re fiskale e cila ka për qëllim nxitjen e ekonomisë formale; tatimi në dividendë është 0%, që paraqet një faktor motivues për bizneset; aktualisht po punohet rreth aplikimit të pushimeve tatimore për bizneset, kohëzgjatja e të cilave do të përcaktohet në varësi të nivelit të investimeve dhe numrit të vendeve të reja të punës që ato do të krijojnë. Me qëllim të nxitjes së aktivitetit prodhues janë ndërmarrë hapa rreth liberalizimit të importit për linjat e prodhimit dhe pajisjeve të nevojshme për prodhim, për lëndën e parë për prodhim (e cila nuk gjendet në Kosovë), si dhe për pajisje të teknologjisë informative. Për të plotësuar komponentin e kostove të lira operative, i cili shihet si faktor motivues për investitorët, Kosova aplikon nivel të ulët të tatimeve.⁸ Sa i përket mënjanimin të barrierave administrative, janë shënuar rezultate në shkurtimin e kohës dhe reduktimin e koston për regjistrimin e biznesit, i cili tani mund të regjistrohet pa pagesë dhe brenda dy ditësh. Është shënuar përparim në reduktimin e lejeve dhe licencave, në ekzekutimin e kontratave, etj. Në aspektin e krijimit të infrastrukturës fizike për punë është investuar në krijimin e parqeve dhe inkubatorëve të biznesit si dhe zonave ekonomike. Rezultate solide janë shënuar edhe sa i përket përmirësimit të infrastrukturës së cilësisë, mbrojtjes së pronësisë intelektuale dhe asaj industriale.

2.3. Vazhdimi i reformave dhe strategjia zhvillimore

Reformat që kanë të bëjnë me përmirësimin e rrethinës së biznesit janë komplekse dhe kërkojnë angazhim konsistent dhe ndër-institucional. Kosova, ashtu sikurse shumë vende të tjera në zhvillim, e ka shndërruar në prioritet këtë objektiv, duke e bërë pjesë të agjendës së Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE). Në mungesë të hulumtimeve të mirëfillta me bazë empirike, të cilat masin

⁸ Tatimi në të ardhurat e korporatës 10%, tatimi në të ardhurat personale 0 - 10 % (progresive), kontributi pensional i obliguar 5%.

cilësinë e faktorëve të të bërit biznes (përparësitë dhe mangësitë), si dhe preferencat e investitorëve për sektorë të caktuar industrialë, Kosova bazohet kryesisht në hulumtimet e organizatave të huaja dhe sidomos në raportin e Bankës Botërore për ‘Të bërit biznes’.⁹ Raporti i Bankës Botërore krahason lehtësinë e të bërit biznes në 189 shtete të ndryshme të botës. Ai merret me analizimin e 10 indikatorëve¹⁰ të cilët vlerësojnë disa komponente që e karakterizojnë lehtësinë (ose jo) të të bërit biznes. Të dhënat merren nga terreni përmes anketave me respondentë, duke siguruar një bazë solide empirike e cila shërben për përpilimin e indeksit final. Indikatorët e Raportit adresojnë aspekte të rëndësishme të rrethinës së biznesit të vendeve, si: legjislacioni dhe zbatimi i tij, infrastruktura, efikasiteti i shërbimeve administrative (burokracia) dhe tregu financiar. Raporti i Bankës Botërore konsiderohet si njëri nga raportet më kredibile sa i përket analizimit të disa indikatorëve të rëndësishëm dhe për këtë arsye rezultatet dhe rekomandimet e tij merren parasysh qoftë nga qeveritë e shteteve, qoftë nga kompanitë e interesuara për të investuar në vende të ndryshme. Në raportin e fundit të Bankës Botërore për vitin 2016, Kosova është renditur në vendin e 66. Krahasuar me disa vite më parë¹¹ mund të thuhet se është shënuar një përparim i konsiderueshëm, mirëpo mbetet shumë për t’u bërë që disa nga indikatorët ku pozicionimi i Kosovës ka qenë më i dobët të përmirësohen. Qeveria e Kosovës, në kuadër të reformave rreth përmirësimit të ambientit të të bërit biznes në vend, i merr parasysh edhe rekomandimet e raportit të

⁹ Përveç raportit ‘Të bërit biznes’ të Bankës Botërore, ekzistojnë edhe raporte të tjera vjetore, si: ‘Indeksi i lirive ekonomike’ (Index of Economic Freedom) i cili publikohet nga ‘Fondacioni Heritage,’ në partneritet me ‘Wall Street Journal; Raporti i konkurrencës globale (Global Competitiveness Report), i cili publikohet nga Forumi Ekonomik Botëror (World Economic Forum), etj.

¹⁰ Indikatorët e raportit të Bankës Botërore për ‘Të bërit biznes’ janë: fillimi i një biznesi; sigurimi i lejeve ndërtimore; sigurimi i energjisë elektrike; regjistrimi i pronës; marrja e kredive; mbrojtja e investitorëve të vegjël; pagesa e tatimeve; tregtia ndërkufitare; zbatimi i kontratave; zgjidhja e falimentimit.

¹¹ Në raportin ‘Të bërit biznes 2012’ Kosova rangohej në pozitën 117 (World Bank, 2012).

Bankës Botërore, duke i harmonizuar ato me strategjitë e tjera nacionale, si: Strategjia kombëtare për zhvillim, Programi për reforma ekonomike, procesi i MSA-së, etj. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë si koordinatore e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik është përgjegjëse për koordinimin e punëve rreth këtij procesi. Roli i saj është përgatitja e rekomandimeve dhe identifikimi i institucione përgjegjëse (në nivel qendror dhe lokal) të cilat merren me adresimin e të gjitha punëve rreth zbatimit të reformave në fjalë.

Duhet theksuar se paralelisht me angazhimin e drejtpërdrejtë në kryerjen e reformave janë të rëndësishme edhe politikat zhvillimore sektoriale të bazuara në ekspertizë, të cilat ndihmojnë qeverinë e vendit për të përcaktuar sektorët industrialë strategjikë. Rreth kësaj Lyubov (2009) pohon se shtetet të cilat i orientojnë investimet e huaja direkte në sektorë apo industri specifike, krijojnë parakushte të cilat nxisin ardhjen e investitorëve. Në këtë frymë Qeveria e Kosovës aktualisht është duke punuar në përcaktimin e sektorëve strategjikë në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, ndërsa në anën tjetër, përmes nxjerrjes së Ligjit për investime strategjike¹² ka paraparë që të ofrojë lehtësira të konsiderueshme, të cilat priten t'i motivojnë kompanitë e mëdha ndërkombëtare për të shtrirë aktivitetin e tyre investues në Kosovë. Prosesi i reformave duhet të jetë punë e vazhdueshme dhe e shoqëruar me analiza të mirëfillta të cilat i masin efektet e politikave paraprake në secilin sektor. Në këtë kuadër vlen të theksohet se asetet e mbetura nga procesi i privatizimit, komponent i cilësuar gjithandej në literaturë si faktor nxitës për tërheqjen e IHD-ve, mund të ndikojë në rritjen e ofertës kosovare karshi investitorëve të huaj të kategorizuar si 'kërkues të aseteve' (asset-seeking FDI).

¹² Ligji për investime strategjike është miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe është në procedurë të rregullt për miratim në Kuvendin e Kosovës.

PËRFUNDIM

Ky punim shpjegoi disa nga faktorët e rëndësishëm të cilët e përkufizojnë rrethinën e të bërit biznes. U tha se ka një konsensus të gjerë sa i përket njohjes së rolit që IHD-të luajnë për ekonomitë e vendeve në tranzicion jo vetëm në aspektin financiar, por edhe për shkak të prurjeve të tjera të cilat sjellin vlerë të shtuar për ekonomitë e vendeve pritëse. Kosova, siç u shpjegua me lart, e njeh rëndësinë e IHD-ve dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit. Për këtë qëllim institucionet e saj kanë ndërmarrë një varg reformash sa i përket përmirësimit të rrethinës së të bërit biznes me qëllim të tërheqjes së sa më shumë investimeve të huaja direkte. Ashtu sikurse shumë vende të tjera, edhe Kosova e ka bërë pjesë të agjendës së saj nacionale përmirësimin e rrethinës së të bërit biznes, duke e trajtuar këtë proces në kuadër të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, i cili i adreson detyrat rreth zbatimit të reformave tek institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal, në bashkëpunim me përfaqësuesit e bizneseve dhe organizatat partnere ndërkombëtare. U konstatua po ashtu se Kosova ka mjaft parakushte për të rritur fluksin e IHD-ve falë resurseve natyrore, kapitalit njerëzor, qasjes së lirë në tregje të mëdha, etj.

Krahas përparimeve të shënuara në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes, Kosova përballlet edhe me shumë sfida të cilat ndërlikohen jo vetëm me reformimin strukturor të resorëve që lidhen drejtpërdrejt me ekonominë, por edhe me përmirësimin e sistemit ligjor dhe funksionimin më të mirë të sistemit demokratik në përgjithësi. Në këtë mes, në mënyrë që vendi të arrijë rezultate më të mëdha në tërheqjen e IHD-ve, duhet të fokusohet me vendosmëri në arritjen e një sërë objektivash të rëndësishme, si: ndërtimi i stabilitetit politik afatgjatë, sundimi i rendit dhe i ligjit, demokratizimi i mëtejme i institucioneve, zhvillimi i politikave ekonomike koherente dhe të

bazuara në ekspertizë, respektimi më i madh i të drejtave të njeriut, qeverisje transparente dhe llogaridhënese, forcim të pronësisë intelektuale dhe asaj industriale, politika të mëtejme nxitëse për bizneset dhe investitorët, arsimim cilësor në përputhje me nevojat e tregut të punës, strategji zhvillimore të sektorëve industrialë, rishikim të modelit të privatizimit të asetëve të mbetura nga ky proces, përmirësim të infrastrukturës fizike, të infrastrukturës së cilësisë dhe asaj të inovacionit.

Aspekt tjetër i rëndësishëm, i cili shihet nga studiuesit si faktor motivues për tërheqjen e IHD-ve, është edhe procesi i integritimit në Bashkimin Evropian (Dunning, 2004), për arsye se përafrimi drejt BE-së nënkupton plotësimin e një sërë standardesh politike dhe ekonomike të cilat e bëjnë më të favorshme rrethinën e të bërit biznes të vendit, duke plotësuar kështu një varg determinantash të cilat ndikojnë në rritjen e investimeve të huaja direkte.

Në fund mund të konkludohet se Kosova ka bërë një varg përparimesh sa i përket përmirësimit të rrethinës së të bërit biznes viteve të fundit, mirëpo meqë ky proces përfshin një mozaik të gjerë faktorësh të cilët e karakterizojnë nivelin e përgjithshëm zhvillimor të vendit si në aspektin politik, ashtu edhe në atë ekonomik, ende mbeten shumë sfida për t'u adresuar në mënyrë që Kosova të shndërrohet në një destinacion i cili do të tërheqë fluks më të madh të investimeve të huaja direkte.

REFERENCAT

- Anghel, B., 2005. *Do Institutions Affect Foreign Direct Investment?* International Doctorate in Economic Analysis, 2-40.
- Ali, F. A, Fiess, N. and Mac Donald, R., 2010. *Do institutions Matter for Foreign Direct Investment*, Open Economic Rev, 21:201-219.
- Barrell, R. and Pain, N., 1999. *Domestic institutions, agglomerations and foreign direct investment in Europe*, European Economic Review, Vol. 43, Issues 4-6, pp. 925-934.
- Bénassy-Quéré, A., Coupet, M. and Mayer, Th., 2007. *Institutional Determinants of Foreign Direct Investment*. The World Economy. Oxford. USA.
- Biglaiser, G. and Garland, M., 2009. *Electoral Systems and Incentives to Foreign Direct Investors: A Cross-National Study*, Paper presented at the annual meeting of the ISA's 50th Annual Convention 'Exploring the past, anticipating the future,' New York: Marriott Marquis.
- Busse, M. and Hefeker, C., 2007. *Political risk, institutions and foreign direct investment*, European Journal of Political Economy, Vol. 23 (2), 397-415.
- BQK, 2015. Prishtinë: Banka Qendrore e Kosovës.
- Bissoon, O., 2012. *Can Better Institutions Attract More Foreign Direct Investment. (FDI)? Evidence from Developing Countries*. International Research Journal of Finance and Economics. Issue 82 (2012), pp.142-159.
- Cooper, R., 2001. *Growth and Inequality: The Role of Foreign Trade and Investment*. Working paper, Cambridge: Harvard University.

- Colin Xu, L., 2010. *The Effects of Business Environments, Surveying New Firm-Level Evidence on Development*. The World Bank Development Research Group, Washington DC: The World Bank.
- Dunning, J. H., 1993. *Multinational Enterprises and the Global Economy*. Harlow, Essex: Addison Wesley publishing Co.
- Dunning, J. H., 2004. *Institutional Reform, FDI and European Transition economies*. International Business and Governments in the 21st Century. Cambridge University Press.
- Krifa-Schneider, H. and Matei, I., 2010. *Business Climate, Political Risk and FDI in Developing Countries: Evidence from Panel Data*. International Journal of Economics and Finance Vol. 2, No. 5.
- Ghosh, G. and Wang, W., 2009. *Does FDI Accelerate Economic Growth? The OECD Experience Based on Panel Data Estimates for the Period 1980 – 2004*. Global Economy Journal. Volume 9, issue 4.
- Lyubov, A. B., 2009. *Strategic Fit for Foreign Direct Investments in Transition Economies*. International Journal of Business and Economics, Volume 9, number 1.
- Markusen, J. R., 1995. *The Boundaries of Multinational Enterprises and the Theory of International Trade*. Journal of Economic Perspectives, No 9 (2).
- Markusen, J. R. and Venables, A. J., 1999. *Foreign direct investment as a catalyst for industrial development*, European Economic Review, Elsevier, vol. 43 (2). pp. 335-356.
- Nicholas, S., 2002. *A Strategy for Development*. Washington, DC: The World Bank.
- Rose-Ackerman, S., 2004. *Foreign Direct Investment: Political Risk and Market Reform*. Brussels, Bruylant: Guy Horsmans Liber Amicorum.
- UNCTAD, 1998. *Trends and Determinants*. World Investment Report. New York and Geneva: The World Bank.

- Wernick, D. A., Haar, J. and Singh, S., 2009. *Do governing institutions affect foreign direct investment inflows? New evidence from emerging economies*, International Journal of Economics and Business Research, Vol. (3), 317-322.
- Wei, S, J., 2000. *How taxing is corruption on internal investors?* The Review of Economics and Statistics, vol. 82, no. 1, pp. 1-11.
- World Bank, 1997. *The State in a Changing World*, Vol. 1. World Development Report. Washington, DC: The World Bank.
- World Bank, 2005. *A Better Investment Climate for Everyone*. World Development Report. Washington, DC: The World Bank.
- World Bank, 2012. *Doing business in a more transparent world*. Washington, DC: The World Bank.
- World Bank, 2014. *Doing Business 2015: Going Beyond Efficiency*. Washington, DC: World Bank.
- World Bank, 2016. *Doing Business 2016: Measuring Regulatory Quality and Efficiency*. Washington, DC: World Bank.

Fatmir Besimi¹ dhe Rilind Kabashi^{2*}

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE – PËRVOJA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

HYRJE

Investimet e huaja direkte (IHD) për një ekonomi të vogël dhe të hapur si ajo e Republikës së Maqedonisë luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik në periudhën e pastranzicionit. Ato ndikojnë në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Gjithashtu, IHD me teknologji të re dhe know-how ndikojnë pozitivisht edhe në rritjen e aftësisë konkurruese të vendit dhe me këtë edhe në përmirësimin e bilancit tregtar të shtetit. Pra, IHD-të pritet të ndikojnë pozitivisht në ekonominë e vendit për disa sfida strukturore që ekzistojnë që nga periudha e tranzicionit – niveli i lartë i papunësisë, deficitit tregtar kronik dhe rritja e ulët ekonomike. Për t'i analizuar IHD-të në ekonominë e Maqedonisë, përvoja tregon që mund të dallohen katër faza kronologjike të IHD-të në aspekt të politikave dhe dinamikës së investimeve.

FAZAT KRONOLOGJIKE TË IHD-VE NË MAQEDONI


Në fazën e parë, përafërsisht prej pavarësimit deri kah viti 1998, niveli i IHD-ve ishte jashtëzakonisht i ulët. IHD-të mes viteve 1994

¹ Qeveria e Republikës së Maqedonisë - Sekretariati për Çështje Evropiane.

² Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë.


* Qëndrimet e paraqitura në këtë analizë janë personale të autorëve dhe nuk paraqesin qëndrime zyrtare të institucioneve ku ata punojnë.

dhe 1997 ishin nën 25 milion dollarë në vit³ (nën 0.7% të PBB-së), kurse në vitin 1998 arritën 150 milion dollarë (4.2% e PBB-së) kryesisht falë shitjes së birrarisë dhe çimentores së Shkupit investitorëve grekë. Shkaku kryesor i shmangies së kapitalit të huaj nga Maqedonia në këtë periudhë ishte perceptimi i saj si vend jostabil, ose si pjesë e një rajoni jostabil të përfshirë në luftërat e ish-Jugosllavisë. Megjithatë, një pjesë e shkaqeve për nivelin e ulët të IHD-ve në këtë periudhë ka të bëjë edhe me faktorë të brendshëm. Në radhë të parë këtu duhet përmendur modeli i privatizimit, i cili kryesisht bazohet në të ashtuquajturin privatizim menaxherial, ku në të shumtën e rasteve persona brenda ndërmarrjeve (insider) ose drejtorët e tyre i blenë ato me çmime relativisht të ulëta. Pengesë e rëndësishme për shitje eventuale të mëtutjeshme të këtyre ndërmarrjeve investitorëve të huaj ishin problemet e njohura të tranzicionit (teknologjia e vjetruar, mbipunësimi, borxhet e mbetura), kurse barriera plotësuese të brendshme paraqitnin pasiguria juridike, korrupsioni dhe tempoja relativisht e ngadalshme e reformave strukturore.



³ Të gjitha të dhënat në këtë analizë janë marrë nga baza e Bankës Botërore në dollarë (World Bank - World Development Indicators, <http://data.worldbank.org/products/wdi>), me përjashtim të të dhënave për strukturën e IHD-ve në Maqedoni sipas shteteve të cilat janë marrë nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (www.nbrm.mk).

Faza e dytë mund të përkufizohet nga lufta e Kosovës në vitin 1999 dhe konflikti i vitit 2001 në Maqedoni. Në rrethana të tilla, mbase nuk mund të pritej rritje dramatike e IHD-ve. Megjithatë, gjatë këtyre tri viteve shënohet një këndellje e IHD-ve në Maqedoni, e cila kryesisht kishte të bënte me perceptimin e rajonit si më stabil pas luftës së Kosovës. Efekt plotësues kishin edhe politikat e atëhershme për privatizim të shpejtuar të ndërmarrjeve të mbetura në pronësi shtetërore, të cilat kryesisht ishin ndërmarrje humbëse dhe me borxhe të mëdha (investimet greke në rafinerinë e naftës dhe në bankën më të madhe afariste në vend dhe investimet në sektorin metalurgjik). Kjo fazë përfundoi me shitjen e ndërmarrjes shtetërore të telekomunikacioneve investuesit hungarez-gjerman në vigjilje të konfliktit të vitit 2001, i cili mbetet investimi bindshëm më i madh individual i huaj në vend (325 milion dollarë, 8.8% e PBB-së së vitit 2001).



Faza e tretë e tërheqjes së IHD-ve fillon pas konfliktit të vitit 2001, gjegjësisht në vitin 2002 dhe mund të thuhet se zgjati deri në krizën globale të vitit 2008. IHD-të shënuan rritje thuajse konstante gjatë kësaj periudhe, si pasojë e kombinimit të disa faktorëve të

volitshëm. Faktori fillestar ishte stabilizimi i vendit nga pasojat e luftës së brendshme, me angazhim të përgjithshëm të faktorëve të brendshëm politikë dhe institucioneve ndërkombëtare, si dhe stabiliteti i mëtutjeshëm makroekonomik dhe financiar. Së dyti, gjatë kësaj periudhe u intensifikua tempoja e reformave ekonomike dhe politike me qëllim të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Marrëveshja e stabilizim-asocimit ishte nënshkruar që në vitin 2001, kurse në vitin 2006 Maqedonia e mori statusin kandidat për anëtarësim në BE. Ky avancim i ndjeshëm në integrimet evropiane, së bashku me faktin që këto reforma lidheshin me ndryshimin e kornizës juridike, luftimin e korrupsionit, liberalizimin e mëtutjeshëm të tregut gjithsesi kishte efekt pozitiv për tërheqjen e kapitalit të huaj. Së treti, gjatë kësaj periudhe vazhdoi privatizimi i ndërmarrjeve të mbetura shtetërore, duke e përfshirë edhe privatizimin e rrjetit të distribuimit të energjisë elektrike nga investitori austriak në vitin 2006 (225 milion dollarë, 3.9% e PBB-së). Së fundmi, pjesa e fundit e kësaj periudhe, kur IHD-të arritën maksimumin që nga pavarësia e deri më sot (gjithsej 1.3 miliard dollarë në vitet 2007-2008, ose mesatarisht 7.2% e PBB-së në vit) përputhet me ekspansionin ekonomik në nivel global, i cili përfshinte edhe rritje të investimeve të huaja.

Faza e fundit në përvojën e Maqedonisë me IHD-të filloi në vitin 2009, pas kulminimit të krizës globale, dhe mund të thuhet se zgjat ende. Pas rënies fillestare të nivelit të investimeve, që ishte e pritshme në vitet e para pas krizës, IHD-të përsëri kanë një trajektore rritëse (duke arritur në mesatarisht 3.4% të PBB-së në vit në dy vitet e fundit). Karakteristikë kryesore e kësaj periudhe është fakti që thuhet të gjitha IHD-të janë të ashtuquajtura greenfield, për dallim prej viteve të mëhershme kur një pjesë e mirë e IHD-ve ishte rezultat i privatizimit të ndërmarrjeve në pronësi shtetërore. Karakteristikë tjetër e rëndësishme është ndryshimi i strategjisë për tërheqje të IHD-ve. Strategjia e viteve të fundit në radhë të parë bazohet në ndërtimin e zonave të lira ekonomike (zonave zhvillimore teknologjike-

industriale). Këto janë zona në disa vende të shtetit, ku qeveria tërësisht e ndërton infrastrukturën e nevojshme dhe pastaj u ofron beneficione të ndryshme investitorëve të jashtëm të cilët vendosin të investojnë në to. Beneficionet të cilat u ofrohen investitorëve të jashtëm në zonat e lira ekonomike, mes të tjerash, përfshijnë lirimin e plotë nga pagesa e tatimit mbi fitim dhe e tatimit mbi të ardhurat personale për 10 vjet, lirimin e plotë nga doganat dhe tatimin mbi vlerën e shtuar për prodhimet, lëndët e para dhe pajisjet, lirimin e plotë nga taksat komunale dhe taksat për ndërtim, mundësinë për subvencion nga qeveria deri në 500.000 euro për shpenzimet e ndërtimit, si dhe mundësinë për marrje të tokës në shfrytëzim deri në 99 vjet. Paralelisht me zonat e lira, strategjia e viteve të fundit për tërheqje të IHD-ve mbështetet edhe në fushatën intensive para kompanive të huaja me qëllim të prezantimit të përparësive krahasuese të Maqedonisë si destinacion për investim (stabiliteti makroekonomik dhe financiar, pozita gjeografike, statusi i kandidatit për anëtarësim në NATO dhe BE, marrëveshjet për tregti të lirë, niveli i ulët i shpenzimeve për fuqi punëtore). Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e kësaj strategjie është edhe vazhdimi i reformave, sidomos i atyre që kanë të bëjnë me ambientin për biznes (siç mund të shihet nga përparimi thuajse konstant në rangimet e Bankës Botërore), si dhe investimet në infrastrukturën e përgjithshme në shtet.

Edhe pse strategjia e re e tërheqjes së IHD-ve, e bazuar kryesisht në zonat e lira ekonomike, është ende në vijim e sipër, përvoja e disa viteve të fundit mundëson nxjerrjen e disa përfundimeve tentative në lidhje me përparësitë dhe mangësitë e saj.



Përparësia kryesore është fakti që kjo strategji është relativisht e suksesshme në aspekt të tërheqjes së investitorëve të huaj, me një mesatare prej 2.8% të PBB-së në periudhën 2009-2014. Një aspekt gjithashtu i rëndësishëm është ndryshimi i strukturës së IHD-ve. Prej pavarësimit e deri në krizën globale investimet kryesisht bazoheshin në shitjen e ndërmarrjeve shtetërore, sidomos ndërmarrjeve të mëdha

ose monopole në sektorë strategjikë (ushqimorë, telekomunikacionet, bankat, rafineria, distribucioni i rrymës), kryesisht në sektorin e “non-tradables”, si dhe në shitjen e ndërmarrjeve në sektorin e metalurgjisë. Nga ana tjetër, investimet e viteve të fundit nuk bazohen në shitje të ndërmarrjeve strategjike apo në industri ekstraktive, por fokusohen në sektorë relativisht të rinj për Maqedoninë, me teknologji më të lartë të prodhimit dhe vlerë më të lartë të shtuar kryesisht në sektorin e “tradables”. Këtu bëhet fjalë në radhë të parë për industrinë automobilistike dhe industrinë shoqëruese, por edhe për industrinë e tekstitit, industrinë kimike, sektorin e teknologjisë informatike, procesimin e ushqimit, etj. Ky ndryshim i strukturës së investimeve kishte efekt pozitiv në rritjen e vazhdueshme të eksportit, si dhe në diversifikimin e strukturës së eksportit.

Nga ana tjetër, duhet të theksohen edhe disa mangësi të strategjisë së viteve të fundit për tërheqje të investimeve. Në radhë të parë ato janë të lidhura me mundësitë për diskriminim që i përmban kjo strategji (krahasuar me kompanitë që veprojnë në tregun vendor). Lidhur me këtë, kjo strategji kritikohet edhe për distorzionet e ndryshme që i imponon në ekonominë vendore në aspekt të transparencës buxhetore jo të mjaftueshme rreth ndihmave që u ofrohen kompanive të huaja sa u përket subvencioneve për shpenzime ndërtimore, si dhe liritë nga obligimet për kontributet në rroga të të punësuarve në zonat e lira. Një dobësi tjetër ka të bëjë me mosbalancin e shtrirjes territoriale të zonave të lira ekonomike që janë operative, ashtu që dy zonat në Shkup dhe ajo në Shtip të jenë më të avancuara, kurse zonat e planifikuara në pjesët tjera janë ende në fazë fillestare, si ajo në Tetovë, Kërçovë dhe Strugë. Së fundmi, një kritikë e përgjithshme vjen nga hulumtimet shkencore të përvojës me zonat e lira ekonomike në nivel global, të cilat nuk japin përfundim definitiv pozitiv për vendet që aplikojnë një politikë të tillë (Madani (1999); Farole and Akinci (2011); Cirera and Lakshman (2014)).

KRAHASIMI RAJONAL

Për të qenë më e plotë analiza e përvojës së Maqedonisë me tërheqjen e IHD-ve do të duhet të vihet në kontekst rajonal për një periudhë më të gjatë kohore. Krahasimi i tillë tregon që edhe përpos tërheqjes së vazhdueshme të investimeve dhe shumave më të larta në vite të caktuara, Maqedonia ka performanca jo të favorshme krahasuar me shtetet tjera ballkanike. Për shembull, pjesëmarrja mesatare e IHD-ve në PBB në vit për periudhën 2005-2014 në Maqedoni është pak më e lartë se ajo në Kroaci, e ngjashme me atë në Rumani, Bosnjë e Hercegovinë dhe Serbi, por shumë më e ulët se sa pjesëmarrja mesatare e IHD-ve në PBB në Shqipëri, Kosovë, Bullgari e Mal të Zi. Performancat janë të ngjashme edhe nëse përdoret kumulativi i IHD-ve për kokë banori prej vitit 2005, ku prijnë Mali i Zi dhe tri shtetet-anëtare të BE-së (Bullgaria, Kroacia dhe Rumania). Edhe pse arsyet janë të shumëllojshme, ndër faktorët kryesorë për një gjendje të këtillë mund të përfshihen vonesat në integrimin evropian, moskompletimi i reformave ekonomike dhe institucionale, jostabiliteti i kohëpas-kohshëm politik, korrupsioni, mungesa e fuqisë së përshtatshme të kualifikuar punëtore dhe mangësitë në lidhjet infrastrukturore me rajonin dhe më gjerë.



PËRFUNDIM

Në fund do të shtojmë se IHD-të vazhdojnë të konsiderohen si faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të vendit. Me qëllim të tërheqjes së IHD-ve do të duhet të udhëhiqen politika konsistente ekonomike, krahas politikave atraktive tatimore për investitorët do të duhet vazhdimisht të përmirësohet klima e biznesit, sundimi i ligjit, stabiliteti dhe parashikueshmëria e legjislacionit, si dhe vazhdimisht të zbatohen reforma strukturore cilësore të cilat do krijojnë ambient të ekonomisë funksionale të tregut. Në këtë drejtim gjithashtu duhet shtuar rëndësinë e stabilitetit politik dhe perspektivën euroatlantike të Maqedonisë dhe rajonit, e cila pritet të jetë sinjal i rëndësishëm pozitiv për vendimmarrjen e investitorëve.

REFERENCAT

- Cirera, X. and Lakshman, R., (2014). *The Impact of Export Processing Zones on Employment, Wages and Labour Conditions in Developing Countries*. 3ie Systematic Review 10. London: International Initiative for Impact Evaluation (3ie).
- Farole, T. and Akinci, G., Editors, (2011). *Special Economic Zones: Progress, Emerging Challenges, and Future Directions*. Washington, DC: The World Bank.
- Madani, D. (1999). A Review of the Role and Impact of Export Processing Zones. *World Bank, Policy Research Working Paper 2238*.

Bedri Hamza* dhe Valentin Toçi**

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SEKTORËT BANKARË NË EVROPËN JUGLINDORE DHE NË KOSOVË

HYRJE

Reforma e sektorëve bankarë në vendet e tranzicionit ishte një proces i gjatë dhe i vështirë. Mungesa e kësaj reforme implikoi kriza të njëpasnjëshme, me kosto të larta fiskale dhe ekonomike. Vetëm pas liberalizimit të këtyre tregjeve për bankat e huaja u arrit funksionimi i sistemeve bankare stabile konform ekonomisë së tregut dhe në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Përvojat e vendeve tjera ishin të dobishme në themelimin e një sektori të shëndoshë bankar në Kosovë, i dominuar nga investitorët e huaj, me dije dhe teknologji të duhur për banking modern.

PRIVATIZIMI DHE HYRJA E BANKAVE TË HUAJA NË EVROPËN JUGLINDORE

Në vendet e tranzicionit, posaçërisht në Evropën Juglindore (EJL), ristrukturimi dhe privatizimi i sistemit bankar ishte një proces i

* Guvernator, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;

** Profesor i Asocuar, Universiteti i Prishtinës dhe Këshilltar për Ekonomi, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Mendimet e shprehura në këtë artikull janë të autorëve dhe nuk duhet të interpretohen si reflektim i pikëpamjeve të institucioneve që përfaqësojnë.

gjatë. Bankat në pronësi shtetërore ishin dominante deri në fund të viteve '90. Përpjekjet fillestare të privatizimit kishin dështuar për të ristrukturuar sektorin dhe hyrja e bankave të huaja ka qenë minimale. Vende të ndryshme kanë ndjekur rrugë të ndryshme të privatizimit të sistemeve të tyre bankare. Për shembull, vendet e ish-Jugosllavisë, si Kroacia, Mali i Zi dhe Maqedonia patën dy periudha kryesore të privatizimit të sistemit bankar. Fillimisht, në fazën e hershme të tranzicionit privatizimi ishte indirekt - përmes privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, që ishin edhe themeluese të bankave komerciale (Kraft et al., 2002). Kjo metodë e privatizimit shpesh la menaxhmentin e vjetër në pozitë të tyre, duke mos përmirësuar qeverisjen. Kreditë e ndërlidhura, kufizimet e buta buxhetore dhe ndërhyrjet politike vazhduan. Më pas, si pasojë e krizave të vazhdueshme në sektor, me zgjidhjen e problemeve në bankat e falimentuara dhe tërheqjen e shtetit nga sektori bankar, privatizimi tek investitorët e huaj strategjikë ka filluar në fund të viteve '90 të shek. të kaluar dhe ka përfunduar shumë shpejt më pas. Kjo çoi në reduktimin e numrit të bankave dhe konsolidimin e sektorit.

Një shembull tjetër është Bullgaria, ku në fazat e hershme të tranzicionit kishte një regjim liberal për hyrje në treg, me kërkesa të ulëta për kapital minimal të nevojshëm për të themeluar një bankë. Bankat e vogla dhe të dobëta vërshuan tregun. Edhe pse shumica ishin efektivisht në duar të sektorit privat, ekspertiza e pamjaftueshme nuk reformoi sektorin (Rostowski, 1995). Në fazën e dytë, pas krizës së vitit 1997, Bullgaria ka ndjekur privatizimin përmes investitorëve të huaj strategjikë dhe nga viti 2000 sektori u konsolidua me pjesëmarrjen dominante të bankave të huaja në sektorin bankar.

Në fazën fillestare të tranzicionit sektori bankar ishte relativisht joefikas, kryesisht në pronësi shtetërore, i pareformuar, me një kapacitet të dobët rregullator dhe mbikëqyrës dhe praktikë të vjetra të kreditimit ua hapën rrugën krizave të njëpasnjëshme. Krizat bankare në rajonin e EJT-së ishin të thella, duke minuar rolin ndërmjetësues të

bankave dhe duke krijuar shpenzime të mëdha fiskale. Për shembull, kostot e vlerësuara të krizave bankare në Bullgari, Kroaci dhe Maqedoni ishin 20-50 për qind e PBB-së, të cilat mund të konsiderohen si krizat më të shtrenjta bankare për atë periudhë (Sonje dhe Vujcic, 1999; Tang et al ., 2000). Kjo çoi në një rënie serioze të besimit në sektorin bankar, duke u reflektuar në nivele të ulëta të ndërmjetësimit financiar. Kushtet për rivendosjen e stabilitetit u krijuan vetëm pas privatizimit të industrisë bankare përmes sjelljes së investitorëve të huaj strategjikë.

Përfshirja fillimisht e ulët e bankave të huaja në EJL dhe në shumë vende në tranzicion ishte për shkak se autoritetet u përpoqën për të ruajtur kontrollin e plotë kombëtar mbi bankat më të rëndësishme (Sevic, 2000). Por edhe për shkak të rrezikut që bankat ekzistuese vendore, të cilat ishin tashmë me probleme, nuk mund të përballojnë rritjen e presionit konkurrues (Buch, 1997). Si rezultat, depozituesit do të mund të humbin kursimet dhe dështimet e bankave mund të kishin efekte të mëdha negative në ekonomi. Megjithatë, kjo ndjenjë shpejt ndryshoi si pjesë e një procesi më të gjerë të liberalizimit të motivuar nga aspiratat për t'u anëtarësuar në BE, ku barrierat e hyrjes u shfuqizuan. Përveç kësaj, ristrukturimi i pasuksesshëm pas privatizimit nga pronarë vendorë dhe nevoja për kapital të freskët e ekspertizë në sektorin bankar demonstroi domosdoshmërinë e liberalizimit ndaj bankave të huaja.

Po ashtu është supozuar se prania më e madhe e bankave të huaja mund të ketë një efekt pozitiv edhe në përmirësimin e performancës së bankave vendore përmes transferimit të teknologjisë dhe dijes. Në vitet e mëvonshme u demonstrua se hyrja e bankave të huaja në treg ka qenë ndoshta një rrugë e pashmangshme për të pasur banka të pavarura, me teknologji moderne dhe të fuqishme. Për më tepër, bankat e huaja kanë kontribuar edhe në kapacitetet rregullatore, duke këmbyer përvoja dhe duke qenë të 'vetërregulluara' nga ana e rregullatorëve në vendet amë. Aktualisht bankat e huaja përbëjnë

pjesën më të madhe të tërë aktiveve të sektorit bankar dhe në shumë raste kjo përqindje arrin në 90 për qind të sektorit.

Literatura njeh disa arsye pse bankat kanë shtrirë aktivitetin e tyre jashtë vendit (Mero dhe Valentinyi, 2003; Cull dhe Martinez-Peria, 2007). Për shembull, një shpjegim është se bankat e huaja 'ndjekin' klientët e tyre jashtë vendit. Megjithatë, një shpjegim më i qëndrueshëm për hyrjen e bankave të huaja në EJT është ekzistenca e mundësive të vendit pritës, ku bankat e huaja kanë një avantazh konkurrues, dijen dhe teknologjinë në ofrimin e shërbimeve financiare. Shumica e literaturës empirike mbi tranzicionin konstaton se bankat e huaja sollën stabilitet dhe efikasitet në sektor. Megjithatë, disa hulumtime efikasitetin më të lartë të bankave të huaja ia atribuojnë fenomenit 'cherry picking', që nënkupton rastet kur bankat e huaja blejnë bankat më efikase vendore. Kjo është në kundërshtim me shpjegimin tjetër që bankat e huaja kanë qenë të përfshira në blerjen e lirë të bankave problematike vendore dhe kanë bërë kthesë në përmirësim të efikasitetit (Havrylchuk, 2006).

Një shqetësim për vendet në tranzicion ishte se bankat e huaja nuk mund të kenë politikën e tyre të kreditimit të orientuar drejt nevojave të tregut të brendshëm¹, pasi që një arsye për t'u zgjeruar jashtë vendit ka qenë 'ndjekja' e klientëve të tyre. Po ashtu, për shkak të problemeve në infrastrukturën e informacionit që bankat e huaja mund të kenë pasur në tregjet lokale dhe politikën e tyre konservative të kreditimit (që rrjedhin kryesisht nga problemet institucionale në vendet e tranzicionit), ekziston evidencë se bankat e huaja kanë qenë më aktive në kreditimin e ekonomive familjare dhe në kreditimin për firmat e mëdha. Në anën tjetër, sektori i NVM-ve ka pasur vëmendje më të vogël, edhe pse ka qenë sektor dominant në këto ekonomi. Bankat e huaja kanë tendencë të jenë të mëdha dhe të kenë një avantazh konkurrues në kreditimin e kompanive të mëdha. Pavarësisht nga kjo, në kohët e fundit ato kanë

¹ Kjo pjesërisht mund të qëndrojë për periudhën e krizës globale financiare 2008.

zhvendosur teknologjinë e tyre të kreditimit drejt NVM-ve, të inkurajuar nga mjedisi më i mirë institucional dhe i biznesit.

Tashmë është gjerësisht e pranuar se bankat e huaja sollën stabilitet në sistemin bankar në vendet e EJL-së. Vlerësimet e institucioneve financiare ndërkombëtare si FMN-ja, Banka Botërore, BERZH-i sugjerojnë se sektorët bankarë në vendet e EJL janë të qëndrueshëm dhe në të shumtën e rasteve nuk ballafaqohen me kërcënime të mëdha për stabilitetin. Klasifikimi i përgjithshëm është se sektorët bankarë janë të shëndetshëm, likuidë, profitabilë, të kapitalizuar mirë, si dhe rregullatorët dhe kapacitetet mbikëqyrëse janë në nivel të duhur.² Kreditimi filloi të bëhet bazuar në praktikat e kreditimit të shëndoshë. Këto masa rezultuan në përmirësim të cilësisë së portofolit kreditor. Sidoqoftë, nivelet e ndërmjetësimit mbeten të ulëta, sepse një pjesë e konsiderueshme e aseteve të sektorit bankar janë investuar në asete të sigurta (letra me vlerë të qeverive vendore ose të huaja), duke reflektuar kështu politikat konservative të kreditimit. Më pas ka pasur një ndryshim në favor të rritjes së kreditimit për sektorin privat vendor. Megjithatë, përkundër rritjes, niveli i kreditimit për sektorin privat në ekonominë e tranzicionit në përgjithësi mbetet më i ulët në krahasim me vendet e zhvilluara.

Ende ekziston hapësirë në këto vende për përmirësim të infrastrukturës së informacionit, p.sh. shpalosjes më të mirë të pasqyrave financiare të firmave, përmirësim në zbatim të ligjit dhe rregullave të kolateralit, procedurat gjyqësore dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut. Të gjitha këto rrisin sigurinë dhe transparencën në kredidhënie, që do të ishte në funksion të rritjes së kreditimit drejt niveleve të vendeve të zhvilluara.

² Këtu përjashtim bën periudha e krizës globale financiare, që mund të konsiderohet ekzogjene në këtë kontekst.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SEKTORIN BANKAR NË KOSOVË³

Kosova ka filluar procesin e tranzicionit rreth një dekadë më vonë se shumica e vendeve të ish-bllokut socialist. Para luftës së vitit 1999, një sistem modern financiar në kuptimin e sigurimit të ndërmjetësimit financiar ishte pothuajse joekzistent. Besimi në sistemin financiar ishte humbur për shkak të ngrirjes së kursimeve në valutë të huaj të qytetarëve nga ana e regjimit të atëhershëm, inflacionit në vitet '90 dhe mosbesimit ndaj regjimit serb. Për më tepër, të gjitha bankat serbe e kishin lënë Kosovën në kohën kur administrata e UNMIK-ut mori detyrën, prandaj Kosova ka krijuar sistemin financiar nga e para.

Në vitin 1999 është themeluar Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, BQK (në atë kohë Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës) për të licencuar, rregulluar dhe mbikëqyrur sektorin financiar dhe për të themeluar një sistem efikas të pagesave. Me asistencë teknike nga institucionet ndërkombëtare, BQK-ja ka miratuar rregullat dhe rregulloret bankare në përputhje me standardet ndërkombëtare. Nga një perspektivë rregullatore, sektori bankar në Kosovë mund të konsiderohet liberal. Barrierat e hyrjes dhe kufizimet në licencim u bazuan vetëm në politikat e kujdesshme të aplikuara nga BQK-ja. Në fillim, për të kufizuar zgjerimin e shpejtë të kredisë, kujdes i veçantë i është kushtuar pozicionit të likuiditetit të sistemit bankar, duke pasur parasysh mungesën e tregut ndërbankar të likuiditetit, skemës së sigurimit të depozitave ose instrumentit të huadhënësit të instancës së fundit. Me themelimin e pjeshëm të këtyre instrumenteve u krijuan parakushtet për rritje domethënëse të kreditimit.

Siç u përmend, vendet e EJJ-së u dominuan nga bankat në pronësi shtetërore në vitet e para të tranzicionit. Privatizimi ka filluar

³ Burim i të dhënave në këtë seksion është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

vetëm në fund të viteve '90 të shek. të kaluar, duke hapur dyert për bankat e huaja. Në Kosovë, megjithatë, sequenca ishte e ndryshme: bankat e huaja ishin të parat që hynë në treg, të ndjekura nga bankat vendore. Për më shumë se një vit në tregun bankar të Kosovës operoi vetëm një bankë, e cila ishte në pronësi të huaj (ProCredit Bank). Deri në vitin 2005 shtatë banka operuan në treg, dy prej të cilave ishin në pronësi të huaj (ProCredit Bank me kapital kryesisht gjerman dhe Raiffeisen Bank me kapital austriak), duke kontrolluar më shumë se 60 për qind të tregut. Në mars të vitit 2006, një bankë e vogël me kapital vendor, me pjesëmarrje prej rreth katër për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar, u mbyll (Banka Kreditore e Prishtinës). Një rishikim nga BQK-ja tregoi se banka ishte josolvente. Mbyllja e kësaj banke nuk e ka vënë sistemin në rrezik, me përjashtim të disa lëvizjeve të vogla të depozitave te bankat e huaja.

Viti 2007 dhe 2008 u karakterizua me hyrje të reja të bankave komerciale me kapital të huaj. Banka Kombëtare Tregtare (BKT), degë e BKT Shqipëria me kapital turk dhe Komercijalna Banka nga Serbia morën licencën për të operuar në tregun bankar në Kosovë. Në këtë periudhë u licencua dhe filloi operimin edhe Türk Ekonomi Bankasi (TEB) nga Turqia. Në janar të vitit 2008 po ashtu filloi aktivitetin edhe NLB Prishtina, bankë me kapital slloven, e cila u krijua nga bashkimi i dy bankave me kapital vendor, Kasabank (KSB) dhe Banka e Re e Kosovës (BRK). Sektorit bankar në Kosovë iu shtuan edhe dy banka me kapital turk, Türkiye İş Bankası në vitin 2012 dhe Ziraat Bankası në vitin 2014, duke çuar numrin e bankave të licencuara në Kosovë në dhjetë. Kapitali i huaj në sektorin bankar në Kosovë kryesisht ka origjinën nga vendet e Bashkimit Evropian, siç janë Gjermania, Austria dhe Sllovenia, ndërsa në kohë të fundit kapitali nga Turqia ka rritur konsiderueshëm pjesëmarrjen.

Para vitit 2000 Kosova kishte pothuajse tërësisht një ekonomi të bazuar në para të gatshme. Depozitat u rritën nga nivele të papërfillshme në rreth 46 për qind të PBB-së në vitin 2014.

Pavarësisht nga hendeku mes monetizimit dhe ndërmjetësimit, roli kreditues i sektorit bankar në ekonominë reale është përmirësuar. Vëllimi i kredisë bankare për sektorin privat është rritur me shpejtësi, nga nivele të papërfillshme në rreth 34 për qind të PBB-së në vitin 2014. Me gjithë rritjen, niveli i ndërmjetësimit financiar vazhdon të konsiderohet relativisht i ulët krahasuar me mesataren e vendeve të rajonit (rreth 48 për qind të PBB-së në vitin 2014). Sipas standardeve ndërkombëtare, ndërmjetësimi mbetet i ulët dhe kjo ndodh për shkak të shumë arsyeve: politikave të kujdesshme të kreditimit të bankave, një mungesë e fondeve dhe aftësi të pamjaftueshme për vlerësimin e rrezikut në vetë bankat, historiku i shkurtër i kreditimit, praktikat e dobëta të kontabilitetit dhe besimin e pamjaftueshëm të kreditorëve në zbatim të ligjeve. Lidhur me këtë të fundit korniza ligjore bazë për funksionimin e ekonomisë së tregut është në vend, për shembull, ligji i falimentimit, ligji i pengut, etj., dhe bazohet në praktikat ndërkombëtare. Së fundmi, implementimi i përmbarimit privat në relacionet kreditore ka përmirësuar funksionimin e ligjit, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm financiar. Megjithatë, disa mangësi në ligjet janë të njohura dhe zbatimi i këtyre ligjeve mbetet një sfidë. Kjo mund të ketë çuar në disponueshmërinë e ulët të kredisë dhe rrezikut të perceptuar të lartë pasqyruar në normat e larta të interesit për një periudhë të gjatë.

Duke dekompozuar kostot e ndërmjetësimit për sektorin bankar të Kosovës, disa faktorë që i kontribuuan normave të larta të interesit mund të listohen si në vijim. Së pari, normat e larta të interesit i atribuohen joefikasiteti (p.sh. kostot e larta operative). Kjo ishte e evidente, ngase përvoja e munguar në sektor dhe nevojat për trajnime ishin të mëdha. Së dyti, perceptimin e rrezikut të bankave (ose rregullatorit) për portfolin kreditor, që reflektohej në provizionime të larta. Së treti, sektori është zhvilluar nga një bazë e ulët (praktikisht zero para vitit 2002) dhe tregu ishte 'pa histori', duke çuar në politikat e kujdesshme të kreditimit. Së katërti, kostot që lidhen me krijimin e

rrjetit bankar, teknologjisë dhe zhvillimin e një game të tërë të produkteve dhe shërbimeve bankare ishin të larta.

Avancimet në këtë sektor tregojnë se procesi i konvergencës ka qenë i shpejtë dhe performanca e sektorit financiar tani në shumë fusha është e krahasueshme me atë të vendeve të tjera (Toçi dhe Hashi, 2013). Viteve të fundit kemi parë trendë gjithnjë në rënie të normave të interesit, duke zbritur në rreth 7.6 për qind në qershor 2015. Treguesit e performancës sugjerojnë se sektori bankar mbetet i kapitalizuar mirë, likuid dhe profitabil. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit qëndroi në 19 për qind në qershor të vitit 2015, e cila është mbi kërkesën minimale rregullatore prej 12 për qind. Likuiditeti i sektorit bankar (matur nga raporti i kredive/depozitave, që qëndroi në 77.9 për qind në qershor 2015) mbetet i lartë. Treguesit e profitabilitetit për sektorin bankar, p.sh. përfitueshmëria e matur me ROA në 2.8 për qind dhe ROE në 26.7 për qind, tregojnë performancë të fortë. Kreditë joperformuese (7.2 për qind të gjithsej kredive në qershor 2015) tregojnë se portofoli i kredisë së sistemit bankar mbetet i kualitetit të mirë, më mirë se mesatarja në EJKL prej rreth 18 për qind. Po ashtu, sektori karakterizohet me zgjerim të aktiviteteve bankare me një gamë të produkteve dhe shërbimeve bankare të krahasueshme me vendet me përvojë më të gjatë në banking modern. Dhe kjo ndodh falë investitorëve të huaj strategjikë që kanë sjellë me vete dijen dhe teknologjinë për banking modern.

PËRFUNDIM

Përvojat e vendeve në tranzicion, përfshirë Kosovën, tregojnë se vetëm me depërtimin e bankave të huaja me traditë bankare është siguruar stabilitet dhe kushte për avancim të sektorit. Bartja e dijes dhe e teknologjisë nga bankat në pronësi të huaj te bankat vendore është një mundësi për t'i qëndruar presioneve konkurruese nga bankat e huaja, që njëherësh implikon nevojën për transfer të stafit dhe investime domethënëse në personel dhe teknologji. Në anën tjetër, rregullatorët duhet siguruar kushte të barabarta të konkurrueshmërisë, duke pasur parasysh fazën në të cilën gjenden bankat në ciklet e tyre të biznesit. Po ashtu, përcjellja e avancimeve në produkte dhe shërbime në sektorin financiar, që rritet vazhdimisht për nga kompleksiteti, implikon nevojën për vëmendje të shtuar nga bankat dhe rregullatori për risqet që mund të kenë për sektorin financiar.

REFERENCAT

- Buch, C. (1997), Opening Up for Foreign Banks: How Central and Eastern Europe Can Benefit, *Economics of Transition*, 5: 339-366.
- Cull, R. and M. S. Martinez-Peria (2007), Foreign Bank Participation and Crises in Developing Countries, *Beyond Transition*, 18: 8-9.
- Havrylchyk, O. (2006), Efficiency of the Polish Banking Industry: Foreign versus Domestic Banks, *Journal of Banking and Finance*, 30: 1975-1996.
- Kraft, E., R. Hofler and J. Payne (2002), Privatization, Foreign Bank Entry and Bank Efficiency in Croatia: A Fourier-Flexible Function Stochastic Cost Frontier Analysis, Croatian National Bank Working Paper, No. 9.
- Mero, K. and M. E. Valentinyi (2003), The Role of Foreign Banks in Five Central and Eastern European Countries, Central Bank of Hungary Working Paper, No. 10.
- Rostowski, J. (1995), The Banking System, Credit and the Real Sector in Transition Countries, in Rostowski, J., ed.: Banking Reform in Central Europe and the Former Soviet Union, Budapest: Central European University Press.
- Sevic, Z. (2000), Banking Sector Reform in South East European Transitional Economies: An Overview, *MOCT-MOCT*, 3: 271-283.
- Sonje, V. and B. Vujcic (1999), Croatia in the Second Stage of Transition 1994-1999, Croatian National Bank Working Paper, No. 1.

Tang, H., E. Zoli and I. Klytchnikova (2000), Banking Crises in Transition Countries: Fiscal Costs and Related Issues, World Bank Working Paper, No. 2484.

Toçi, V. and I. Hashi (2013), Intermediation Efficiency of Banks in South-East Europe: An Empirical Assessment Using Dea and Malmquist Index, *International Journal of Finance & Banking Studies*, 2: 1-20.

Alban Hashani¹

PROCESI I PRIVATIZIMIT DHE INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

HYRJE

Privatizimi në vendet në tranzicion, krahas reformave të tjera, është konceptuar si një nga shtyllat bazë të transformimit të ekonomisë nga ajo centraliste në atë të tregut. Kosova është vendi i fundit nga ish- blloku i Evropës Lindore i cili ka filluar procesin e privatizimit në një shkallë të gjerë. Ky proces, krahas qëllimit që të ristrukturojë ekonominë, ka shërbyer edhe si një mjet i rëndësishëm i tërheqjes së investimeve të huaja direkte (IHD) në të gjitha vendet në tranzicion, sikundër edhe në Kosovë. IHD-të dhe procesi i privatizimit kanë pasur një ndërlidhje të ngushtë në të gjitha vendet ku është kryer privatizimi. Literatura ekzistuese sugjeron se tërheqja e IHD-ve përmes procesit të privatizimit është i rëndësishëm, para se gjithash për shkak se IHD-të pritet të sjellin teknologji dhe njohuri të reja, që mundësojnë përmirësimin e efikasitetit dhe aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve të privatizuara. Gjithashtu IHD-të, krahas kushteve të tregtisë së lirë, pritet të rrisin aftësinë konkurruese të kompanive vendore, duke i vënë këto të fundit përballë një presioni më të madh konkurrues. Së fundi, IHD-të sinjalizojnë një përmirësim të mjedisit afarist, duke rritur tërheqjen e investitorëve të rinj dhe duke krijuar

¹ Drejtor i kërkimeve në Institutin Riinvest dhe ligjërues në Kolegjin Riinvest. Qëndrimet e paraqitura në këtë punim janë autoriale.

shtytës për përmirësim të mëtejshëm të mjedisit afarist. Ky punim synon që të prezantojë shkurtimisht ndërlidhjen ndërmjet procesit të privatizimit dhe IHD-ve në Kosovë. Fillimisht, punimi trajton procesin e privatizimit në Kosovë, duke filluar nga periudha e ish-Jugosllavisë. Më pas punimi trajton nivelin dhe tiparet e IHD-ve të ndërlidhura me procesin e privatizimit, përderisa pjesa e fundit e punimit paraqet disa konkluzë.

PRIVATIZIMI NË KOSOVË

Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë ka filluar në vitin 1989 në bazë të ligjit mbi kapitalin shoqëror. Megjithatë, numri i kompanive që kanë kaluar nëpër këtë proces ka qenë shumë i vogël. Në atë kohë procesi i privatizimit ishte ndërprerë shumë shpejt për shkak të fillimit të masave të dhunshme që pasuan pas suprimimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989 dhe fillimit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Gjatë kësaj periudhe mijëra të punësuar ishin larguar nga puna; pasuritë e këtyre ndërmarrjeve ishin vjedhur e zhvleftësuar, përderisa kishte mungesë sistematike të investimeve. Pas luftës, si pasojë e amortizimit të mjeteve dhe teknologjive dhe ndryshimeve në mjedisin afarist rajonal dhe ndërkombëtar, shumica e këtyre ndërmarrjeve vepronin në mënyrë joefektive dhe nën nivelin e kapaciteteve, ndërsa shumica prej tyre kishin pushuar komplet operacionet e tyre bazë (Riinvest, 2001). Administrata ndërkombëtare bëri përpjekjet e tij të para drejt privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në vitin 2000, duke i komercializuar ato përmes një marrëveshje qiradhënie 10-vjeçare. Ky aranzhman u zgjodh, para se gjithash, për të shmangur çështjen atëherë të ndjeshme të pronësisë apo të pretendimeve të kreditorëve. Ky proces dëshmoi të jetë kompleks dhe i vështirë për t'u menaxhuar dhe ishte cilësuar si i papërshtatshëm. Prosesi i mirëfilltë i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore ka filluar në vitin 2002 nën kujdesin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), duke vazhduar pas pavarësimit të vendit nën kuadrin e

Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). Privatizimi i ndërmarrjeve publike, në anën tjetër, është kryer nga Qeveria e Kosovës si pronare në mirëbesim e këtyre ndërmarrjeve (Riinvest, 2002; 2004a; 2004b; 2008).

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE TË NDËRLIDHURA ME PRIVATIZIMIN

Investimet e huaja direkte (IHD) në të gjitha vendet e tranzicionit kanë pasur një ndërlidhje të ngushtë me procesin e privatizimit. Megjithatë, ndërlidhja nuk ka qenë e njëtrajtshme. Përderisa IHD-të janë dominuar nga investimet e huaja në procesin e privatizimit, të njëjtat nuk kanë qenë metoda dominuese e privatizimit. Sidoqoftë, studimet tregojnë se IHD-të janë përcjellë me ristrukturim më të shpejtë të ish-ndërmarrjeve shtetërore-shoqërore. Tërheqja e IHD-ve përmes procesit të privatizimit është i rëndësishëm për shumë arsye - mes tjerash, fillimisht, ato pritet të sjellin teknologji dhe njohuri të reja që mundësojnë përmirësimin e efijencës dhe aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve të privatizuara. Gjithashtu, IHD-të, krahas kushteve të tregtitë së lirë pritet të rrisin aftësinë konkurruese të kompanive vendore, duke i vënë këto të fundit përballë një presioni më të madh konkurrues. Së fundi, IHD-të sinjalizojnë një përmirësim të mjedisit afarist, duke rritur tërheqjen e investitorëve të rinj dhe duke krijuar shtytës për përmirësim të mëtejshëm të mjedisit afarist.

Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë ka shfaqur një ndërlidhje të ngjashme me IHD-të si edhe në vendet tjera në tranzicion. Afërsisht një në njëmbëdhjetë ndërmarrje të privatizuar është privatizuar përmes IHD-ve, qoftë në mënyrë të pjesshme apo të plotë. Megjithatë, duhet theksuar se një nga tri ndërmarrjet e privatizuar përmes IHD-ve është privatizuar nga diaspora kosovare (Riinvest, 2008). Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë ishte ndërprerë disa herë, megjithatë gjatë kohës kur kishte një rrjedhë të mirë, është përcjellë me rritje të përshpejtuar të nivelit të

IHD-ve. Sa i përket vlerës së IHD-ve të lidhur me procesin e privatizimit, ato arrijnë shumën në mbi 85 milion euro, që përfaqësojnë rreth 13 për qind të të hyrave të përgjithshme nga procesi i privatizimit (AKP, 2015). Kjo shumë përfaqëson vetëm nivelin e konfirmuar të të hyrave nga IHD-të dhe në rast të kadastrimit rigoroz statistikor niveli i IHD-ve nga procesi i privatizimit mund të jetë më i lartë. Gjatë viteve 2005, 2006 e 2007, kur procesi i privatizimit ishte në kulmin e tij, janë shënuar edhe nivelet më të larta të IHD-ve në Kosovë, të cilat patën kulmuar në vitin 2007 (BQK, vite të ndryshme). Vetëm gjatë këtyre viteve vlera e investimeve të huaja nga procesi i privatizimit ishte mbi 50 milion euro (AKP, 2015). Struktura e IHD-ve gjatë periudhës më të ngjeshur me procesin e privatizimit tregon se pjesëmarrja e IHD-ve në sektorin e industrisë ishte më i lartë, diku tek një e pesta e gjithë IHD-ve (BQK, vite të ndryshme). Kjo pasqyron edhe përqendrimin relativ të ndërmarrjeve shoqërore në sektorin e industrisë. Në mënyrë të veçantë privatizimi në industrinë e eksploatimit dhe përpunimit të metaleve ka tërhequr vëmendjen e investitorëve të huaj. Në vijim niveli i IHD-ve nga procesi i privatizimit ka shënuar rënie për shkak të ngadalësimit të këtij procesi. Numri i transaksioneve në periudhën pas vitit 2007 ishte shumë më i vogël, që reflekton edhe përmbylljen e këtij procesi. Origjina e IHD-ve në procesin e privatizimit është kryesisht nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, mirëpo ka edhe investitorë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërsa në masë më të vogël nga shtetet e rajonit. Edhe kjo pasqyron shtrirjen gjeografike të vendeve ku graviton më tepër diaspora kosovare, por ka pasur edhe investitor të rrallë nga vendet aziatike (Rinvest, 2008).

PËRFUNDIM

Për dallim nga vendet tjera nga ish-bloku i Evropës Lindore, që kishin filluar procesin e transformimit të ekonomive të tyre nga ajo centraliste në atë të tregut në fillim të viteve 1990, Kosova ka filluar një proces të tillë afërsisht një dekadë më vonë. Për më tepër, gjatë kësaj dekade Kosova u gjend nën kushte të masave të dhunshme pas suprimimit të autonomisë, të cilat masa u përcollën me shkatërrim të ndjeshëm të ekonomisë së Kosovës, në mënyrë të veçantë të bazës së saj industriale.

Procesi i mirëfilltë i privatizimit në Kosovë ka filluar me shumë vonesë dhe ishte përcjellë me pengesa të mëdha. Megjithatë, metoda e privatizimit e përdorur në Kosovë ka krijuar parakushte të mira për tërheqjen e IHD-ve. Madje koha gjatë së cilës ky proces ka pasur rrjedhë normale është përcjell me nivelet më të lartë të IHD-ve në Kosovë. Metoda e privatizimit e përdorur në Kosovë nuk krijonte ndonjë pabarazi ndërmjet investitorëve të huaj e vendorë, si dhe nuk ofronte ndonjë përparësi për punëtorët apo menaxherët (siç ishte e zakonshme në të gjitha vendet tjera në tranzicion). Metodatat që favorizonin punëtorët dhe menaxherët apo popullatën vendëse në tërësi (në rastin e privatizimit masiv) nuk krijonin kushte të favorshme për tërheqjen e investimeve. Megjithatë, edhe përkundër faktit se mënyra e privatizimit në Kosovë nuk diskriminonte IHD-të, ky proces ka rezultuar me nivele modeste të tërheqjes së investitorëve. Kjo çështje para se gjithash reflekton gjendjen e mjedisit afarist të një vendi pas luftës, krahas faktit se këto ndërmarrje nuk ishin më në gjendje të mirë pas shkatërrimeve të viteve të 90-ta të shek. të kaluar. Për më tepër, Kosova ishte bashkëngjitur e fundit në garën rajonale për tërheqjen e IHD-ve, përderisa kapacitetet për të bërë një gjë të tillë ishin më të kufizuara. Madje, si pasojë e krizës globale financiare të vitit 2008, niveli i IHD-ve pas këtij viti kishte rënë në tërë rajonin dhe ky nivel njëtrajtësisht kishte rënë edhe në Kosovë.

REFERENCAT

AKP (2015) ‘Origjina e investitorëve’ *Agjencia Kosovare e Privatizimit, Prishtinë* [të dhëna të papublikuara].

BQK (vite të ndryshme) ‘Raporti vjetor’ *Banka Qendrore e Kosovës, Prishtinë*.

Riinvest (2001) ‘Ndërmarrjet shoqërore dhe privatizimi’, *Instituti për Hulumtime Zhvillimore - Riinvest, Prishtinë*.

Riinvest (2002) ‘Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe reformimi i shërbimeve publike në Kosovë’ *Instituti për Hulumtime Zhvillimore - Riinvest, Prishtinë*.

Riinvest (2004a) ‘Privatizimi në Kosovë: përparimet dhe ngecjet’ *Instituti për Hulumtime Zhvillimore - Riinvest, Prishtinë*.

Riinvest (2004b) ‘Statusi i pronës shoqërore në Kosovë: kontestet dhe privatizimi’, *Instituti për Hulumtime Zhvillimore - Riinvest, Prishtinë*.

Riinvest (2008) ‘Privatizimi në Kosovë: një gotë gjysmë bosh apo gjysmë e plotë’ *Instituti për Hulumtime Zhvillimore - Riinvest, Prishtinë*.

Petrit Gashi*

MBI NJË ORIENTIM KONCEPTUAL NË
POLITIKËBËRJE DHE DY MEKANIZMA TË
RËNDËSISHËM NË TËRHEQJEN E IHD-VE NË
KOSOVË¹

HYRJE

Në Kosovën e pas luftës, si në tërë bllokun ish-socialist, politikëbërja në fushën e ekonomisë është bazuar përgjithësisht mbi premisat e të ashtuquajturit Konsensus i Vashingtonit, një paketë politikash të ndërtuara mbi premisën e fundamentalizmit të tregut. Kjo e fundit pretendon se tregu është i vetmi mekanizëm që siguron efikasitet ekonomik. Si rezultat i kësaj, që nga periudha e menaxhimit ndërkombëtar strategjia zhvillimore në Kosovë është fokusuar në sigurimin e stabilitetit makroekonomik, me theks të veçantë në sigurimin e disiplinës fiskale, liberalizimin e tregut dhe të kapitalit dhe privatizimin e pronës shoqërore. Në frymën tipike neoliberales, çfarë prezanton Konsensusi i Vashingtonit, roli i shtetit-qeverisë u përkufizua si periferik në zhvillimet ekonomike. Sikur sqaron Stiglitz (2008), politikat e bazuara në këtë paradigmë presupozojnë më të keqen për natyrën, aftësitë dhe kapacitetet e qeverive nacionale. Ky qëndrim ndikoi në zvogëlimin e përpjekjeve për ngritjen e kualitetit

* Profesor i asociuar, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës.
petrit.gashi@uni-pr.edu

¹ Prezentuar në Tryezën shkencore të organizuar nga ASHAK “Investimet e huaja direkte në Kosovë”, 22 dhjetor 2015.

institucional apo të mekanizmave shtetërorë që do të intervenonin në ekonomi në mënyrë efikënte. Sipas Stiglitz-it, nga frika e çrregullimeve më të mëdha që do të shkaktonte intervenimi i shtetit në ekonomi dhe synimi i tyre të ndërtojnë një 'kallëp' të vetëm në politikëbërje (pra, receta standarde politikash që iu përshtaten të gjitha vendeve), politikëbërja në vendet në zhvillim, përfshirë edhe ato në tranzicion, u bazua kryekëput në mekanizmat e tregut.

Jeta institucionale në Kosovën e pas vitit 1999 dhe defektet e vazhdueshme që kanë përcjellë ndërtimin dhe funksionalitetin e institucioneve janë një argument i fortë kundër përfshirjes më të madhe të shtetit në ekonomi. Mungesa e theksuar e kapaciteteve njerëzore dhe teknike në administratën shtetërore, niveli i dokumentuar i korrupsionit, burokracia, performansa e dobët e mekanizmave të zbatimit të ligjit, ofrimi joefikënt i shërbimeve publike dhe i infrastrukturës përcjellëse, moszbatimi i kontratave, mosmbrojtja e pronës intelektuale janë argumente shumë të fuqishme kundër përfshirjes së qeverisë në jetën ekonomike në Kosovë. Sipas paradigmës neoliberales, një aparat i tillë jofunksional shtetëror domosdoshmërisht do t'i përkeqësonte edhe më shumë problemet ekonomike. Në këtë rast prezenca më e madhe e shtetit në ekonomi vetëm do t'i hapte rrugën rritjes së presionit dhe të ndikimit nga grupet e interesit, që në Kosovë janë thjesht grupime të ndryshme politike dhe partiake, dhe me këtë do të shkaktonte çrregullime edhe më të mëdha në treg, madje jo vetëm ekonomike.

Mirëpo edhe pas pesëmbëdhjetë vitesh tranzicion (që në rastin e Kosovës tranzicioni nënkupton shumë më tepër se sa definimi tradicional i tranzicionit si proces i transformimit të sistemit nga ai i komanduar në atë të bazuar në treg) problemet ekonomike janë të thella. Shpërpjesëtimet makroekonomike janë shumë të mëdha, norma e papunësisë e tejkalon 30 për qindëshin, ndërsa varfëria – veçanërisht ajo ekstreme – është në përmasa të papranueshme.

Ndoshta është e padrejtë që e gjithë barra e vështirësive ekonomike në Kosovë t'i atribuohet strategjisë neoliberale të zbatuar, pasi që historia e Kosovës në dekadat e fundit është shumë më komplekse, gjë që ka determinuar edhe zhvillimet ekonomike në vend, po, megjithatë, shembujt e shumtë në literaturë dhe përvojat e vendeve të ndryshme dokumentojnë dështimin e theksuar të qasjes zhvillimore neoliberale,² duke favorizuar, në anën tjetër, qasjen zhvillimore – e cila prodhoi rezultate shumë të mira veçanërisht në vendet e Azisë Lindore – dhe atë neostrukturaliste, që iu siguroi sukses ekonomik vendeve të caktuara në Amerikën Latine. Të dy këto rryma mbështeten në idenë se pjesëmarrja aktive e shtetit në ekonomi është esenciale për rritjen e potencialit ekonomik të vendit dhe të mirëqenies së qytetarëve. Sipas këtyre qasjeve, problemet me nivelin e ulët të rritjes ekonomike në vendet në zhvillim, pastaj me produktivitetin e ulët dhe me shpërndarjen disproporcionale të të hyrave mund të zbuten vetëm përmes reformave të thella dhe investimeve në sistemin e edukimit dhe të shëndetësisë, pastaj në politikat për riorientimin e shpenzimeve buxhetore dhe përmes politikave aktive industriale (për më tepër shih Gore, 2000).

Pra, sikur sqaron Stiglitz (2008), periudha e paskonsensusit ka konsoliduar dihotominë shtet – treg.³ Sot qeveria dhe mekanizmat e tregut shihen si komplementare dhe jozëvendësuese. Në këtë kontekst ka një pajtim të gjerë se dështimet e tregut janë po aq të mëdha sa ato të qeverisë. Për më tepër është krijuar konsensus edhe mbi qasjet sistematike për të përmirësuar performansën e qeverisë, mirëpo edhe

² Krizat ekonomike të njëpasnjëshme, duke filluar në Meksikë, Azi Lindore, Rusi dhe Argjentinë dokumentuan fundamentet e brishta të paketës neoliberale zhvillimore. Stiglitz (2008) argumenton se edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për të modifikuar recetat e politikbërjes në kontekst të Konsensusit të Washingtonit, defektet ishin të paevitueshme, që ndërlihdeshin hiç më pak se me moskuptimin e drejtë të funksionimit të mekanizmave të tregut dhe me horizontin e ngushtë të objektivave politikbërëse.

³ Shih Agjendën Zhvillimore të Barcelonës, një përgjigje ndaj paradigmes së Konsensusit të Washingtonit (Serra dhe Stiglitz, 2008).

të tregut. Në raste të caktuara është vetë qeveria ajo e cila ndikon në performasën më të mirë të tregut.

Viteve të fundit politikëbërja në Kosovë ka identifikuar rëndësinë e një riorientimi më strategjik në drejtim të dizajnit të politikave zhvillimore të cilat do të gërshetonin rolin e shtetit me atë të tregut. Së pari, diskutimi në vijim shkurtimisht flet për këtë riorientim konceptual në politikëbërjen kosovare dhe insiston që në kontekst të investimeve të jashtme duhet të jetë edhe më i theksuar; dhe, së dyti, për dy pengesa kryesore të cilat duhet t'i adresojë Kosova për të tërhequr investitorë të huaj, por edhe për të rritur efektet e këtyre të fundit në ekonominë e Kosovës.⁴

RIORIENTIMET NË POLITIKËBËRJE DHE MEKANIZMAT PËR TËRHEQJEN E IHD-VE

Në librin e tij *In Defense of Globalization*, Jagdish Bhagwati argumenton si në vijim (2004):

...rritja ekonomike ... kërkon një qeveri e cila ndërmerr hapa aktiv në ekonomi përmes politikave të ndryshme, ngritjen e infrastrukturës rrugore dhe porteve, si dhe duke tërhequr fonde të jashtme.

Bhagwati, profesor i ekonomisë në Universitetin e Kolumbias, edhe pse një përkrahës i madh i liberalizimit të tregut, konfirmon atë që u tha më herët për rëndësinë e përfshirjes aktive të shtetit në

⁴ I tërë ky diskutim mund të vendoset edhe në kontekst të politikës industriale. Kjo e fundit ka shtrirje të gjerë; si politikë industriale përkufizohet çfarëdo intervenimi selektiv i qeverisë, edhe i tërthortë, që synon të zhvendosë strukturën prodhuese nga një apo më shumë sektorë drejt sektorëve të cilët kanë potencial më të madh për rritje dhe zhvillim ekonomik (shih Rodrik, 2007). Sot politika industriale shihet nën një dritë të re dhe ka për qëllim bashkërendimin e interesave publike me ato të sektorit privat. Rodrik (2007) sqaron se suksesi i politikës industriale varet nga koordinimi strategjik ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat me qëllim të identifikimit të pengesave kryesore në procesin e ristrukturimit ekonomik, si dhe çfarë intervenimesh kërkohen me qëllim të eliminimit të këtyre pengesave.

ekonomi. Mirëpo për diskutimin tonë pika më e veçantë e pasusit ka të bëjë me rëndësinë që Bhagwati i jep rolit të qeverisë në “tërheqjen së fondeve të huaja”, e që thjeshtë i referohemi si investime të huaja direkte (IHD). IHD-të konsiderohen vitale për ristrukturimin ekonomik të vendeve në zhvillim. Investimet e huaja janë shumë të rëndësishme për këto vende pasi që përvoja tregon se sjellin kapitalin, dijen, konkurrencën, të cilat janë deficitare në këto vende. Për më tepër, nga investimet e jashtme përfitojnë edhe kompanitë vendore, për shembull, përmes absorbimit më të lehtë të dijes dhe teknologjisë.

Sipas interpretimit të Harrison-it dhe Rodríguez-Clare-it (2010), Bhagwati i propozon qeverive dizajnimin e një sistemi specifik të insentivave vetëm për investitorët e huaj. Nga këndi i doktrinave ekonomike, që i diskutuam më heret, dizajnimi i politikave të cilat do të favorizonon agjentët e caktuar ekonomikë (në këtë rast investitorët e huaj), ndërsa të tjerët do të neglizhoheshin (investitorët vendorë), tregon që mekanizmat vendimmarrës janë duke u tërhequr nga parimi i neutralitetit në politikëbërje apo i trajtimit të barabartë të aktorëve në ekonomi: ndërmarrjeve, investitorëve, apo industrive.⁵ Në rastin e Kosovës, kjo do të përbënte një ndryshim të rëndësishëm në filozofinë e politikëbërjes, e cila, në vazhden e orientimeve neoliberales, gati në tërësi është e ndërtuar mbi premisën e neutralitetit, edhe pse viteve të fundit ka një zhvendosje graduale në drejtim të diferencimit të aktorëve në ekonomi. Politikat ekonomike në Kosovë thërrasin për trajtim të barabartë të bizneseve në tregtinë e jashtme, importues apo prodhues vendorë (neutraliteti është siguruar përmes politikës tatimore

⁵ Sipas Harrison-it dhe Rodríguez-Clare-it (2010), prezenca e eksternalitetëve është arsytmi kryesor teorik për devijim nga neutraliteti në politikëbërje. Eksternalitetet definoohen si efekte anësore, pozitive apo negative, që prodhon vendimi i një agjenti ekonomik tek agjentët e tjerë në treg, duke ndikuar në nivelin e dobishmërisë (*utility*) apo në strukturën e kostove. Për shembull, në rastin e investimeve të jashtme, insentivat e ndryshme për tërheqjen e këtyre të fundit mund të arsyetohen mbi bazën e eksternalitetëve të dijes që krijon prezenca e investitorëve të jashtëm tek kompanitë vendore, pasi që firmat e huaja iu bëjnë të mundur firmave vendore të absorbojnë më shpejt *know-how* dhe teknologjitë e avancuara.

të Kosovës, që përcakton obligime të njëjta për të gjitha kompanitë). Për më tepër, insistohet në trajtim jodiskriminues të investitorëve të huaj karshi atyre vendorë (*trajtimi nacional* i investitorëve të huaj, sipas frymës së Organizatës Botërore të Tregtisë). Përtej këtij trajtimi, insentivat për investitorët e huaj janë të kufizuara, çfarë pjesërisht shpjegon pjesëmarrjen e vogël të investimeve të huaja direkte në Kosovën e pasluftës. Për fund, Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë masa të kufizuara sektoriale të cilat kanë filluar të aplikohen vetëm viteve të fundit. Këto masa janë përqendruar në tërësi në sektorin e bujqësisë, ndërsa sektorët e tjerë industrialë janë neglizhuar.

Në rastin e Kosovës, duke mos pretenduar të zvogëlojmë rëndësinë e një sistemi të menduar mirë të insentivave për investitorët e huaj, prapë prioritet duhet t'u jepet problemeve të thella strukturore të cilat ndikojnë në atraktivitetin e Kosovës si vend pritës i IHD-ve.

Por cilat janë ato pengesa specifike që duhet t'i adresojë Qeveria me qëllim të tërheqjes së IHD-ve në Kosovë? Nëse përdorim logjikën e modelit Hausmann, Rodrik dhe Velasco (shih Rodrik, 2007), apo të modelit të “diagnostifikimit të rritjes” (*growth diagnostics*), vendimmarrja në Kosovë duhet të jetë selektive në targetimin e problemeve strukturore me të cilat ballafaqohet.⁶ Është e pamundur që institucionet të ballafaqohen me të gjitha sfidat përnjëherë, andaj edhe modeli propozon të listohen sipas intensitetit dhe shtrirjes pengesat strukturore në vend, veçanërisht ato që ndikojnë në vendimet e investitorëve të jashtëm për të investuar apo vendimet për të zgjeruar aktivitetin dhe ndikimin në ekonominë e Kosovës. Në rastin e parë është e rëndësishme të analizohen motivet (çfarë i demotivon?) e investitorëve të jashtëm për të investuar në Kosovë (faktorët të cilët ndikojnë në vendimin e tyre për të depërtuar në tregun e Kosovës);

⁶ Nuk duhet harruar që modeli është dizajnuar për të analizuar faktorët e rritjes ekonomike e jo determinantat e investimeve të jashtme. Si do që të jetë, faktorët që i trajtojmë në vijim dhe që konsiderojmë se duhet të trajtohen me prioritet nga institucionet janë po të njëjtë që janë duke e frenuar edhe rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

ndërsa në rastin e dytë duhet parë investimet e jashtme nga prizmi i efekteve të tërthorta – eksternaliteteve – në zhvillimin e ndërmarrjeve vendore.

Vendimi për të investuar në Kosovë, si dhe eksternalitetet nga operacionet e bizneseve të huaja në ato vendore janë ngushtë të lidhura me dy faktorë: nivelin e burimeve njerëzore në Kosovë dhe kualitetin institucional. Në asnjë mënyrë nuk pretendohet që këta janë të vetmit faktorë që ndikojnë në vendimet e investitorëve të huaj. Është e njohur gjithashtu se problemet janë specifike për industri. Mirëpo hulumtimet empirike dhe përvojat e vendeve të tjera tregojnë që kualiteti i burimeve njerëzore dhe performansa institucionale e bën një vend atraktiv për investitorët e huaj.

Në kontekst të motiveve të bizneseve të huaja për të investuar jashtë vendit, literatura liston nevojën për qasje në burime, treg, efikasitet apo zotërim të aseteve strategjike (shih Dunning dhe Lundan, 2008). Kosova dyshoj që mund të jetë atraktive për investitorët që kërkojnë treg apo synojnë asete strategjike. Mirëpo Kosova mund të jetë potencialisht atraktive për investitorët të cilët kërkojnë burime kualitative dhe të lira apo rritje efikasiteti. Pasuritë natyrore të Kosovës janë të dokumentuara. Gjithashtu, fuqia punëtore e re është potencial i i madh. Mirëpo shfrytëzimi efikasitet i këtyre burimeve – natyrore apo njerëzore – kërkon parakushte të caktuara. Në rastin e burimeve natyrore, investitorët e huaj janë shumë të ndjeshëm ndaj riskut të përgjithshëm të vendit. Risku politik dhe ekonomik në Kosovë buron nga defektet institucionale në vend, si dhe zhvillimet politike të pas viteve 1999. Edhe me tutje institucionet kosovare nuk e kanë kontrollin e plotë mbi burimet natyrore në disa pjesë të vendit. Për më tepër, shfrytëzimi racional i burimeve kërkon një infrastrukturë institucionale, e cila është e vendosur mbi parimet e transparencës dhe të llogaridhënies me qëllim të evitimit të ndikimit të grupeve të interesit dhe të menaxhimit të keq të burimeve. Janë pikërisht këto arsye që e kanë prodhuar idenë e ‘mallkimit të

resurseve'. Në rastin e burimeve njerëzore, duhet gjykuar që këto burime nuk janë të përgatitura si duhet për tregun e punës, pasi që sistemi arsimor në të gjitha nivelet ballafaqohet me probleme të thella.⁷ Si rrjedhojë, potenciali i këtij burimi është i kufizuar për shkak të nivelit të ulët të shkathtësive dhe aftësive të fuqisë punëtore. Për më tepër, ata të cilët kanë nivel të lartë të edukimit dhe të shkathtësive janë krahasimisht të kushtueshëm me vendet e rajonit, që ndikon në atraktivitetin e Kosovës për investitorë të huaj (Banka Botërore, 2010).

Kur flasim për efektet,⁸ atëherë duhet të jemi të vetëdijshëm se flasim për kompani të cilat veç e kanë të shtirë aktivitetin e tyre në Kosovë. Pra, në esence flasim për vendime të firmave të huaja për zgjerim të aktivitetit apo krijim të kushteve të krijimit të eksternaliteteve të firmat vendore. Sa i përket të parës, përmes mekanizmave të ndryshëm – lehtësirave tatimore apo insentivave të tjera – këto firma mund të nxiten të zgjerojnë investimet dhe aktivitetin e tyre në Kosovë. Në rastin e dytë situata është shumë më komplekse, sepse eksternalitetet pozitive të IHD-ve sipas literaturës janë të varura ekskluzivisht nga kushtet që ekzistojnë në tregun e brendshëm. Alfaro (2013), Kalemlı-Ozcan dhe Sayek (2009) sqarojnë se vendet i stimulojnë investimet e huaja, sepse presin që këto të fundit do t'u bëjnë të mundur ndërmarrjeve vendore të absorbojnë dijet dhe teknologjitë e tyre. Mirëpo, siç argumentojnë autorët, sukcesi i

⁷ Duke devijuar pjesërisht nga thelbi i këtij studim të shkurtër, një observim nga Rodrik (2007) është jashtëzakonisht relevant për situatën në sistemin arsimor në Kosovë:

Për një kohë të gjatë politikbërësit kanë menduar se përmirësimi i kualitetit të burimeve njerëzore lidhet me ngritjen e infrastrukturës arsimore: më shumë shkolla, më shumë mësimdhënës, më shumë tekste dhe qasje më të madhe në të trijat. Këto intervenime e rritën ofertën për shkollim ..., mirëpo rritja e pjesëmarrjes në shkollim nuk prodhoi rritjen e pritur të produktivitetit. Arsyeja është e thjeshtë. Pengesa kryesore ishte kërkesa për shkollim - apo propensiteti i ulët për nxënie – në ekonomitë ku mundësitë e pakta ekonomike zvogëlojnë përfitimet apo kthimin nga shkollimi.

⁸ Sikur e potencuam më heret, literatura përmbledh efektet e investimeve të jashtme në disa çështje: gjenerim të punësimit, rritje të eksportit; transfer të dijes dhe asimilim të teknologjisë, etj. (Dunning dhe Lundan, 2008).

firmave vendore në absorbimin e teknologjisë dhe të dijes varet në masë të madhe nga specifikat e tregut lokal, veçanërisht ato që lidhen me kualitetin e burimeve njerëzore dhe me nivelin e përgjithshëm institucional në vend. Problemet me njëri nga këto, sipas autorëve, do të reduktojnë kapacitetin e firmave vendore të absorbojnë teknologjitë apo dijet e reja dhe të reagojnë karshi sfidave dhe mundësive që krijohen me hyrjen e firmave të huaja në tregun vendor. Për shembull, sipas autorëve, zhvillimi i institucioneve financiare, apo i tregut të kapitalit, është vital në absorbimin e teknologjive të reja dhe dijes. Me fjalë të tjera, çfarë është jashtëzakonisht relevante për Kosovën, qasja e kufizuar në kreditim kufizon aktivitetet ndërmarrëse apo zhvillimin e ndërmarrësisë. Sipas Alfaro-s (2013), nëse ndërmarrësia bën të mundur asimilim dhe adoptim të praktikave më të mira teknologjike që ofrohen nga investitorët e jashtëm, atëherë tregjet e pazhvilluara financiare limitojnë potencialin e eksternaliteteve pozitive nga investimet e jashtme të kompanitë vendore.

PËRFUNDIM

Ky studim i shkurtër diskutoi nevojën për një ndryshim konceptual në politikëbërje dhe trajtoi më në thellësi dy mekanizma determinues të hyrjes dhe të zgjerimit të aktivitetit të kompanive të huaja në Kosovë. Së pari, theksoi nevojën e një përfshirjeje më aktive të shtetit në tërheqjen e investimeve të huaja. Kjo, u tha, kërkon një lëvizje nga parimi i neutralitetit në politikëbërje, pasi që rëndësia e investimeve të huaja në ristrukturimin ekonomik është shumë e madhe. Së dyti, punimi theksoi rëndësinë e dy defekteve strukturore në ekonominë e Kosovës, që sipas gjykimit, janë pengesë kryesore për investimet e huaja në Kosovë. Nga cilido kënd të analizohen, kualiteti i burimeve njerëzore apo niveli i performansës institucionale prezantohen si pengesa të theksuara për investimet e jashtme. Së treti, insistohet që defektet e lidhura me burimet njerëzore dhe institucionet duhet të trajtohen me prioritet në raport me sistemin e insentivave specifike që duhet dizajnuar për të tërhequr investitorët e jashtëm. Kjo edhe për faktin se zgjidhja e problemeve strukturore do të përmirësonte performansën e përgjithshme ekonomike në Kosovë dhe jo vetëm të rriste fluksin e investimeve të jashtme.

REFERENCAT

- Alfaro, L. (2013). Foreign direct investment: effects, complementarities and promotion. Në *Partners or Creditors: Attracting foreign investment and productive development to Central America and Dominican Republic*. Edituar nga Auguste, S., Cuevas, M. dhe Manzano, O. Publikim nga Inter-American Development Bank.
Shih: <http://www10.iadb.org/intal/intalcdi/PE/2015/15307en.pdf>.
- Alfaro, L., Kalemli-Ozcan, S. dhe Sayek, S. (2009). FDI, Productivity and Financial Development. *World Economy* 32(1): 111-135.
- Banka Botërore (2010). Kosovo - Unlocking Growth Potential: Strategies, Policies, Actions, Report No. 53185-XK, Vashington: Banka Botërore.
- Bhagwati, J. (2004). *In Defense of Globalization*. Oxford: Oxford University Press.
- Dunning, J. dhe Lundan, S. (2008). *Multinational Enterprises and the Global Economy*. Cheltenham: Edward Elgar.
- Gore, C. (2000). The Rise and Fall of the Washington Consensus as a Paradigm for Developing Countries. *World Development* 28(5): 789-804.
- Harrison, A. dhe Rodríguez-Clare, A. (2010). Trade, Foreign Investment, and Industrial Policy for Developing Countries. Në *Handbook of Development Economics*. Volumi i pestë. Edituar nga Rodrik, D. dhe Rosenzweig, M. (2010). Holandë: North-Holland.
- Rodrik, D. (2007), *One Economics, Many Recipes*, New Jersey: Princeton University Press.

Serra, N. dhe Stiglitz, J. (2008). *The Washington Consensus Reconsidered: Towards a New Global Governance*. Oxford: Oxford University Press.

Stiglitz, J. (2008). Is there a Post-Washington Consensus Consensus?. Në *The Washington Consensus Reconsidered: Towards a New Global Governance*. Edituar nga Serra, N. dhe Stiglitz, J. (2008). Oxford: Oxford University Press.

Nazmi Zeqiri dhe Avdullah Hoti

TREGU I PUNËS – TËRHEQËS DHE DEKURAJUES I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

Abstrakt

Kursimet e brendshme janë të pamjaftueshme për vendet në zhvillim, përfshirë Kosovën, për të financuar investimet e domosdoshme për të mbajtur rritjen ekonomike në nivele të qëndrueshme. Investimet e huaja luajnë rol kyç në plotësimin e kësaj zbrazëtire. Në këtë punim analizohet efekti i kushteve të tregut të punës në tërheqjen e këtyre investimeve. Kjo analizë shkon përtej teorisë standarde ekonomike, që e shpjegon trendin e investimeve të huaja në një vend përmes insentivave të politikave fiskale dhe monetare, si dhe përcaktuesit tradicionalë të investimeve të jashtme si kursi i këmbimit, faktorët institucionalë, madhësia e tregut etj.

Në rastin e Kosovës, vetëm pas disa vitesh tranzicion të pasluftës u vërejt se faktor determinues për investime të jashtme është fuqia absorbuese e forcës punëtore. Studimet empirike e mbështesin këtë argument, e cila gjë shtron nevojën për avancimin e njohurive të forcës punëtore në përputhje me trendët ndërkombëtare. Në veçanti ky punimi avokon për përmirësimin e shkathtësive profesionale dhe të adaptueshme të forcës punëtore, përfshirjen e të gjitha palëve të interesit në këtë

proces përmes bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve arsimore dhe trajnuese me sektorin privat, si dhe rolit aktiv të shtetit në krijimin e shkathësive të nevojshme në kuadër të sektorit privat.

HJRJE

Një nga problemet ekonomike të shteteve në zhvillim, përfshirë Kosovën, është se kursimet e brendshme dhe kapitali për investime është i pamjaftueshëm për të financuar investimet e domosdoshme që sigurojnë rritje të qëndrueshme afatgjate. Prandaj këto vende kanë nevojë të vazhdueshme për kapital shtesë, i cili mund të sigurohet përmes Investimeve të Huaja Direkte (IHD).

Hulumtimet e shumta tregojnë (sidomos për vendet e pazhvilluara dhe vendet në zhvillim) se IHD-të, përveç sigurimit të kapitalit shtesë investues, sjellin edhe përfitime të tjera për vendin mikpritës, siç është transferimi i teknologjisë, rritja e konkurrencës, rrjetëzimi i kompanive vendore dhe të huaja, promovimi i kapitalit njerëzor dhe efekte të tjera anësore pozitive.

Megjithatë, tërheqja e investitorëve të huaj në vendet si Kosova kërkon qasje dhe politika që janë komplekse dhe që nuk kufizohen vetëm në sferën e ekonomisë. Asnjë vend nuk është në gjendje të tërheqë sasinë, cilësinë dhe llojin e dëshiruar të IHD-ve, sikurse asnjë investitor i huaj nuk është në gjendje të investojë kapitalin e tij pa studiuar kushtet lokale në vendin mikpritës.

Për të kuptuar ndërlidhjen ndërmjet investitorëve të huaj dhe kushteve vendore, me rëndësi është të studiohen faktorët përcaktues të vendimit të investitorëve të huaj për të bërë investime në një vend të caktuar. Ndër faktorët e shumtë që ndikojnë në vendimin për të investuar, vend qendror zë stoku dhe cilësia e kapitalit njerëzor. Kjo bazohet kryesisht në qëndrimin se i vetmi faktor që përcakton diferencat ndërmjet vendeve sa i përket konkurrueshmërisë dhe produktivitetit është faktori njeri, kështu që investitorët janë në kërkim të tregjeve ku

forca punëtore është e disponueshme dhe me shkathësi adekuate. Në rastin e Kosovës, që dominohet nga një popullsi e re, kapitali njerëzor mund të bëhet përcaktuesi kyç për tërheqjen e IHD-ve.

Derisa në vendet e zhvilluara ka debate për dhe kundër IHD-ve (sidomos rreth llojit të IHD-ve kur një investim mund të bëhet nga kapitali vendor), në vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim ekziston një pajtueshmëri rreth nevojës për IHD për të përmbushur nevojën për investime që nuk mund të realizohen përmes investimeve vendore. Si rezultat, tërheqja e IHD-ve shpeshherë bëhet objektiv i rëndësishëm në politikat ekonomike të qeverive. Debati i gjerë zhvillohet kryesisht rreth gjetjes së përcaktuesve që ndikojnë në tërheqjen e investitorëve të huaj. Një përcaktues i IHD-ve që ka marrë vëmendjen e shumë hulumtuesve padyshim është stoku dhe cilësia e kapitalit njerëzor.

KONTEKSTI EKONOMIK DHE ROLI I KAPITALIT NJERËZOR NË TËRHEQJEN E IHD-VE

Vite më parë politikat ekonomike për tërheqje të IHD-ve kanë konsistuar në insentivat tradicionale fiskale dhe monetare për të stimuluar investitorët e huaj. Megjithatë, si rezultat i globalizimit, zhvillimit të avancuar teknologjik, komunikues, etj., tërheqja e investitorëve të huaj dhe sidomos i atyre strategjikë nuk mund të shpjegohet plotësisht duke u bazuar vetëm në teorinë tradicionale ekonomike. Kjo pikëpamje merr parasysh përcaktuesit si: kursi i këmbimit, tatimet, institucionet, niveli i mbrojtjes dhe madhësia e tregut.

Teoritë e fundit dhe studimet empirike (Moosa 2002; Hoti 2005; Spagat 2006; Enache 2010; Rizvanolli 2010) tregojnë se ka më shumë përcaktues të IHD-ve sesa përcaktuesit tradicionalë dhe ky numër është në rritje. Në shumë prej këtyre studimeve kapitali njerëzor është shumë i rëndësishëm dhe nganjëherë përcaktues kryesor në tërheqjen e IHD-ve. Në disa studime kapitali njerëzor është i pozicionuar si parakusht për tërheqjen e IHD-ve, në veçanti për tërheqjen e llojit të caktuar të IHD-ve.

Në këtë drejtim, në rastin e Kosovës (sikurse edhe në vendet të tjera në tranzicion), në vitet e para të tranzicionit kapitali njerëzor nuk ishte parashikuar si problem sa i përket tërheqjes së IHD-ve. Kur filloi tranzicioni studiues të shumtë argumentuan se niveli i kapitalit njerëzor ishte i lartë dhe nuk konsideroj si sfidë për zhvillim ekonomik dhe tërheqje të IHD-ve. Në shumicën e studimeve ky opinion bazohej në nivelin e arsimit të arritur të forcës punëtore, por jo edhe përshtatshmërinë e sistemit të arsimit dhe shkathtësive të fituara të të diplomuarve me kërkesat e industrisë dhe ndryshimeve dinamike që kishin ndodhur në tregun e punës.

Jo shumë vonë, u kuptua se sistemi arsimor i trashëguar, si dhe njohuritë dhe aftësitë ekzistuese që kishte forca punëtore nuk ishin në përputhje me kërkesat e reja të tregut, e në veçanti më kërkesat e investitorëve strategjikë dhe investimeve të huaja me orientim afatgjatë. Në shumicën e rasteve kapitali njerëzor ishte relativisht lirë në terma nominal, por jo i përshtatshëm nga aspekti i kompetencave, njohurive, përvojës, etj. Si rezultat, shpejt u kuptua se potenciali njerëzor është përcaktues për IHD-të, sidomos në sektorët ku kapitali njerëzor është faktori kryesor i prodhimit që krijon vlerën e shtuar. Kjo ishte shumë e evidente sidomos me IHD-të në sektorin e shërbimeve, të teknologjisë informatike dhe komunikuese etj.

Popullsia shumë e re e Kosovës paraqet një përparësi krahasuese sa i përket potencialit të forcës punëtore në të ardhmen e afërt. Por në të njëjtën kohë kjo është një sfidë e madhe për politikëbërësit që të kanalizojnë dhe të orientojnë këtë potencial drejt nevojave që ka tregu dhe interesimeve që shfaqin investitorët (MEST, 2011).

Një nga brengat më të mëdha është se aftësitë dhe kompetencat e punëtorëve nuk janë në përputhje me kërkesat që ka sektori privat, duke sugjeruar kështu nevojën për ndryshime të mëtejme në sistemin e arsimit dhe trajnimit. Komuniteti i biznesit dhe institucionet akademike duhet të bashkëpunojnë më tepër për të siguruar

përputhshmëri në mes të aftësive dhe kompetencave të fituara nga arsimimi dhe nevojat e biznesit.

Edhe pse janë bërë hapa të mëdhenj në reformimin e sistemit arsimor, sidomos në përshtatjen e kornizës ligjore dhe kurrikulare me vendet të BE-së, zbatimi dhe përshtatshmëria me kushtet e ekonomisë lokale dhe më gjerë nuk është e kënaqshme. Kjo e nxitë nevojën jo vetëm për përmirësimin dhe reformimin tutje të sistemit arsimor në Kosovë, por edhe monitorimin e rezultateve që dalin nga sistemi si tërësi.

Ka ende shumë pak studime për sa i përket ndërlidhjes ndërmjet IHD-ve dhe kapitalit njerëzor në Kosovë. Evidenca ekzistuese bazohet në monitorimet dhe studimet sipërfaqësore të institucioneve ndërkombëtare, të cilat nuk mjaftojnë për të kuantifikuar efektin e kapitalit njerëzor në IHD-të që do të ishte me interes për vendimmarrje. Anketat e fundit nga Agjencia e Statistikave e Kosovës dhe raporti i fundit vjetor i UNDP-së lidhur me zhvillimet e resurseve njerëzore në Kosovë tregojnë se niveli i ulët i cilësisë së kapitalit njerëzor në Kosovë mbetet pengesë për zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik si dhe për tërheqjen e IHD-ve.

Nga një hulumtim i realizuar më 2013 (dhe i përsëritur edhe më 2014) me 30 kompanitë më të mëdha të huaja që kishin investuar në Kosovë, si dhe me 10 përfaqësuesit e tyre institucionalë (odat ekonomike, KIESA, shoqatat, etj.) ka rezultuar se kapitali njerëzor ka qenë përcaktues i rëndësishëm me efekt pozitiv në vendimmarrjen e tyre për të investuar në Kosovë. Megjithatë, hulumtimi ka zbardhur një fakt tjetër interesant, ku rezulton se kapitali njerëzor ka qenë kufizues sa i përket vendimit për të zgjeruar më tutje biznesin e këtyre kompanive në Kosovë. Kjo nënkupton se Kosova posedon kapital njerëzor të mjaftueshëm dhe të lirë, por jo të cilësisë së duhur dhe të kërkuar nga biznesi, sidomos në disa sektorë të caktuar ku IHD-të ka gjasa më të mëdha të ndodhin (Zeqiri, 2010).

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Kapitali njerëzor padyshim duhet të trajtohet si resurs ekonomik shumë i çmuar, por edhe si sfidë për aftësinë konkurruese të ekonomisë së Kosovës.
- Tërheqja e investitorëve të huaj (përveç stimujve monetarë dhe fiskalë) duhet të shoqërohet me zhvillimin e vazhdueshëm të kapitalit njerëzor përmes krijimit të lidhjeve më të forta ndërmjet institucioneve arsimore dhe bizneseve. Kjo lidhje duhet të forcohet sidomos në përpilimin dhe përshtatjen e vazhdueshme të kurrikulave me nevojat e bizneseve, në veçanti me bizneset e huaja.
- Të sigurohet rritja e fondeve publike dhe private për sistemin e arsimit dhe trajnimeve, sidomos tek pjesa e profesioneve ku mund të përfitohet një kompetencë e veçantë dhe e kërkuar nga investitorët e huaj. Sistemi i Gjermanisë në arsimin profesional mund të jetë një mundësi e mirë për t'u kopjuar në kuptimin pozitiv të fjalës. Rritja e fondeve duhet të përcillet me matjen e performances së outputit arsimor.
- Një fushë me rëndësi për t'u mbështetur është eksporti i shërbimeve. Në këtë sektor ka mjaft “storie të suksesit” dhe replikimi i këtyre mund të ndikojë në rritjen e partneritetit ndërmjet kompanive lokale dhe atyre ndërkombëtare.
- Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) duhet të rrisë kapacitetet e saj informuese në promovimin e kapitalit njerëzor si përparësi konkurruese, fillimisht si kosto e ulët e kapitalit dhe më tutje si aftësi specifike që ka fuqia punëtore në Kosovë.
- Duhet të bëhet decentralizimi i aktiviteteve që lidhen me promovimin e IHD-ve, sidomos duhet të rritet roli i pushtetit lokal në ofrimin e stimujve për IHD si dhe koordinim të shtuar ndërinstitucional ndërmjet

të gjithë aktorëve që janë të përfshirë në çështjet institucionale që lidhen me tërheqjen e IHD-ve.

- Masa specifike duhet të dizajnohen për tërheqjen e kapitalit nga diaspora, e cila ka akumuluar përvojë të konsiderueshme sa i përket kapitalit njerëzor në vendet ku është e koncentruar si diasporë kosovare. Kjo mund të bëhet me rishikimin e politikave tatimore për rastet kur “storiet e suksesit” të diasporës mund të jenë të “përsëritshme” edhe në Kosovë.
- Si masë e përkohshme afatshkurtër dhe si shtytës fillestar mund të aplikohet subvencionimi i pagave për punësimin që bëjnë kompanitë e huaja, të cilat kanë plane të zgjerimit të biznesit të tyre në Kosovë, duke u fokusuar në sektorë që kanë përparësi krahasuese dhe potencial zhvillimor për të ardhmen.

REFERENCAT

Enache, I. T. (2010). Searching for human capital determinants of foreign direct investment inflows in the EU new member states. *Annales Universitatis Apulensis Series Oeconomica*, 12 (1), pp. 483 – 494.

Hoti, A. (2005). *Assessing the problem of human capital mismatch in the transition economies: The case of Kosova*. Prishtina: Institute for Development Research - RIINVEST.

Moosa, I. (2002). *Foreign direct investment. Theory, evidence and practice*. Hampshire - UK: Palgrave Publisher, Ltd. (formerly Macmillan Press, Ltd).

Spagat, M. (2006). Human capital and the future of transition economies. *Journal of Comparative Economics*, 44–56.

Rizvanolli, A. (2010). The effect of human capital on foreign direct investment: a meta-regression analysis. *Riinvest Institute/AAB-Riinvest University conference "Activating Sources of Economic Growth in Kosovo"* (pp. 1-30). Prishtina: Riinvest Institute for Development Research.

MEST. (2011). *Kosovo education strategic plan 2011 - 2016*. Prishtina: Ministry of Education, Science and Technology-MEST.

Zeqiri, N. (2010). *The impact of FDI in transition economies: the experience of Hungary and Albania, and lessons for Kosova*. Germany: Lambert Academic Publishing.

Artane Rizvanolli¹

TËRHEQJA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE DHE ROLI I KAPITALIT NJERËZOR

HYRJE

Nga këndvështrimi i vendit të destinimit të tyre, investimet e huaja direkte (IHD) konsiderohen më atraktive në krahasim me format tjera të transfereve ndërkomëbtare të kapitalit (siç janë investimet portfolio ose investimet tjera si huatë komerciale, etj.), duke qenë se këto janë relativisht më stabile përgjatë kohës dhe nuk krijojnë borxhe (UNECE, 2001; Albuquerque, 2003). Përveç thjesht rolit të financimit të investimeve, përfitimet që një vend mund t'i ketë nga IHD janë të shumëfishta. Këto përfshijnë efektet direkte në formën e transferit të njohurive ('kno-how') teknologjike e menaxheriale nga ana e investuesit, por edhe ato indirekte ('spill-over') në ekonominë e vendit ku realizohet investimi, p.sh. përmes ngritjes së njohurive të firmave vendore (p.sh. për produkte, inpute, teknika prodhimi e të tjera të reja) dhe të punëtorëve (të cilët pastaj mund ta bartin përvojën në firma të tjera), inkurajimin e formimit të 'grupeve industriale' ('industrial clusters'), etj. (shih Rizvanolli, 2010, për diskutim më të detajuar).

Duke marrë parasysh të gjitha përfitimet (potenciale) nga IHD, gjatë dekadave të fundit këto kanë qenë fokus i hulumtimeve të shumta akademike dhe i agjendës së politikëbërësve. Hulumtimet në

¹ Kolegji Riinvest. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë punim janë të autores dhe nuk reflektojnë domosdo qëndrimet e Kolegjit Riinvest ose stafit të tij.

këtë fushë identifikojnë një sërë faktorësh që potencialisht përcaktojnë lokacionit ku investuesit realizojnë IHD-të, përfshirë madhësinë dhe normën e rritjes së tregut vendor, qasjen në tregjet tjera, faktorët institucionalë (përfshirë sundimin e ligjit), infrastrukturën fizike, koston e punës, kapitalin njerëzor, etj. (Rizvanolli, 2010). Ky punim fokusohet në efektin e cilësisë së kapitalit njerëzor si faktor në tërheqjen e IHD-ve.

Ky punim është i organizuar si në vijim. Pjesa e dytë e këtij punimi paraqet argumentet teorike dhe gjetjet empirike nga vendet tjera mbi efektin e kapitalit njerëzor në tërheqjen e IHD-ve. Duke marrë parasysh mungesën e hulumtimeve (rigoroze) mbi këtë temë në Kosovë, Pjesa e tretë tenton të vijë në përfundim mbi rëndësinë që kapitali njerëzor me gjasë ka në këtë kontekst, duke marrë parasysh dëshmitë anekdotike mbi përvojat e investuesve të huaj (potencialë), hulumtimet mbi tregun e punës dhe shkathtësitë e fuqisë punëtore në përgjithësi. Pjesa e katërt përfundon me implikimet e kësaj analize për politikëbërjen në Kosovë.

LIDHJA NDËRMJET KAPITALIT NJERËZOR DHE IHD-VE: ARGUMENTET TEORIKE DHE GJETJET EMPIRIKE

Megjithëse lidhja ndërmjet kapitalit njerëzor dhe IHD-ve shpesh anashkalohet në literaturën e IHD, argumentet teorike për këtë lidhje mund të mbështeten në teorinë e kapitalit njerëzor dhe teorinë e rritjes ekonomike. Në bazë të këtyre teorive mund të identifikohen tre mekanizma përmes të cilëve kapitali njerëzor e bën një vend atraktiv për IHD-të: ngritja e produktivitetit të fuqisë punëtore (p.sh. Becker, 1988; Mankiw et al., 1992), promovimi i aktiviteteve inovative (Romer, 1990; Cosar, 2011) dhe përdorimi (e adaptimi) i teknologjive të reja në procesin e prodhimit (Nelson dhe Phelps, 1966; Goldin dhe Katz, 2010; Acemoglu dhe Autor, 2012). Mekanizmi i fundit është i rëndësishëm jo vetëm për vëllimin e IHD-ve, por edhe në nivelin

teknologjik të IHD-ve që një vend tërheq dhe në aktivitetet që investuesit e huaj i zgjedhin t'i zhvillojnë në një vend².

Përkundër argumenteve teorike më lart, rezultatet empirike sa i përket ndikimit të kapitalit njerëzor në IHD nuk janë gjithmonë në përputhje me pritjet teorike (shih Rizvanolli, 2010, për analizë të literaturës). Kjo vlen për analizat kuantitative për vendet relativisht të ngjashme me Kosovën (vendet në tranzicion), si dhe për vendet tjera (vendet në zhvillim dhe vendet e zhvilluara). Në përgjithësi këto analiza janë bërë në nivel makroekonomik. Analizat në nivel të industrive-sektorëve ekonomikë janë të rralla, por edhe rezultatet e tyre nuk përkrahin përfundimisht hipotezën se kapitali njerëzor tërheq IHD-të. Sipas rezultateve të Rizvanollit (2012), në vendet në tranzicion të Evropës, vëllimi i kapitalit njerëzor (i matur si përqindje e popullatës që kanë përfunduar shkollimin e mesëm dhe atë lartë) nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në IHD-të në nivel makroekonomik dhe në nivel të industrisë përpunuese, por cilësia e arsimit ka ndikim pozitiv në IHD-të që këto vende tërheqin në industritë me nivel më të lartë teknologjik.

Arsyet për këto rezultate mund të jenë të ndryshme. Për shembull, qasja e studimit të kësaj çështjeje në nivel makroekonomik (por edhe në atë të sektorit-industrisë) mund të jenë të papërshtatshme. Për shembull, për disa lloje të investimeve, siç janë ato në sektorët e shërbimeve që synojnë tregun vendor ose ato që synojnë burimet natyrore të një vendi, kapitali njerëzor është relativisht më pak i rëndësishëm në krahasim me faktorët tjerë; meqë investuesit e huaj shpesh mund të paguajnë paga më të larta dhe mund të tërheqin punëtorët më të shkathët, vëllimi i kapitalit njerëzor në nivel të vendit mund të jetë matës jo shumë relevant për ta. Pastaj matësit e kapitalit

² Niveli teknologjik dhe aktivitetet e investuesit të huaj pastaj kanë implikime për përfitimet që vendi mund t'i ketë në aspekte të ndryshme, përfshirë efektet pozitive në transferimin e shtathtësive në nivelin teknologjik të firmave konkurrenente, shkathhtësive të fuqisë punëtore dhe në nivelin e produktivitetit, eksportit dhe rritjes së ekonomisë në nivel të vendit.

njerëzor që janë në dispozicion nuk janë idealë: përtej matësve të vëllimit në të shumtën e rasteve nuk mund të kontrollohet për cilësinë e arsimit, përbërjen e tij (në kuptim të llojeve të kualifikimeve - profesioneve), nivelin e trajnimeve (formale dhe joformale), njohjen e gjuhëve të huaja, kulturën e punës, etj. Për më tepër, ka shkathtësi dhe karakteristika të tjera të cilat punëdhënësit i vlerësojnë, por duket se sistemet e shkollimit në vendet në tranzicion nuk i kanë zhvilluar dhe vazhdojnë të mos i zhvillojnë. Për shembull, të dhënat kualitative në nivel të ndërmarrjes në vendet në tranzicion tregojnë se menaxherët e huaj kanë hasur probleme me fuqinë punëtore në vendet në tranzicion, kështu që sipas tyre punëorët kanë pak vetiniciativë, nuk janë inovativë dhe nuk kanë vullnet për t'u përfshirë në planifikim (Suutari and Riusala, 2000).

LIDHJA NDËRMJET KAPITALIT NJERËZOR DHE IHD-VE NË KOSOVË

Sa i përket IHD-ve në Kosovë në mënyrë specifike, nuk ka ndonjë hulumtim (rigoroz) mbi efektin e kapitalit njerëzor. Sektorët ku IHD-të kanë qenë substanciale, siç janë sektori bankar dhe telekomunikimi, janë sektorë që për qëllim parësor kanë ofrimin e shërbimeve për qytetarët e vendit dhe, si të tilla, nuk mund të argumentohet që janë ndikuar nga niveli i kapitalit njerëzor. Nga ana tjetër janë raportuar raste kur investuesit e huaj potencialë në sektorin e industrisë përpunuese e kanë konsideruar Kosovën si destinacion të investimit dhe janë tërhequr duke pasur si shkak mungesën e fuqisë punëtore me shkathtësi dhe me kualifikime - certifikime relevante të njohura ndërkombëtarisht, megjithëse nuk është e qartë nëse kjo ka qenë arsyeja e vetme kryesore për tërheqjen e tyre.

Kjo është në përputhje me gjetjet e hulumtimeve të mëhershme në Kosovë, të cilat tregojnë se bizneset raportojnë mungesa të punëtorëve të kualifikuar në fusha specifike, por edhe pakënaqësi me nivelin e shkathtësive të punëtorëve edhe kur ata kanë kualifikimet

relevante. Për shembull, bizneset identifikojnë si problem mungesën e shkathtësive “praktike” (për dallim prej “diturive”), që me sa duket i referohet shkathtësive për të zbatuar dituritë e fituara me qëllim të zgjidhjes së problemeve në botën reale (p.sh. Riinvest, vite të ndryshme). Bizneset gjithashtu, përveç mungesës së profesionistëve të fushave specifike, në mënyrë specifike identifikojnë si problem mungesën e shkathtësive të përgjithshme siç janë ato të komunikimit, hulumtimit, zgjidhjes së problemeve, menaxhimit (të projekteve), ‘të mësuarit për të mësuar’ (p.sh. Riinvest, 2011; SEECCEL, 2013). Pastaj, përkundër rritjes së shpejtë të numrit të studentëve në arsimin e lartë, koncentrimi i tyre ka qenë në biznes, ekonomi, drejtësi e shkencë të tjera shoqërore (MASHT, 2013).

PËRFUNDIM

Nga aspekti i politikëbërjes, implikimet e analizës më lart janë të shumëfishta. Së pari, për operimin më produktiv, bizneseve qoftë kosovare, qoftë të huaja, përmirësimi i cilësisë së shkollimit dhe ofrimi i programeve që janë në përputhje me nevojat e tregut është jetik. Përkundër tendencës që lidhja e arsimit me tregun e punës të fokusohet në arsimin profesional dhe arsimin e lartë, është me rëndësi të njihet rëndësia e niveleve më të ulëta të shkollimit, aty ku shkathtësitë e përgjithshme të cekura më lart në fakt (duhet të zhvillohen) zhvillohen. Së dyti, për tërheqjen IHD-ve në mënyrë të veçantë dhe në afat më të shkurtër është me rëndësi që të nxitet ofrimi i certifikimeve të aftësisë profesionale, të cilat janë të njohura ndërkombëtare. Fushat specifike të këtyre aftësimeve dhe mënyrat e nxitjes a ofrimit të këtyre certifikimeve do të duhej të ishin objekt i studimeve të veçanta për nevojat e tregut dhe modalitetet e mundshme të ofrimit të certifikimeve (p.sh. përmes partneriteteve publiko-private).

REFERENCAT

- Albuquerque, R., 2003. The composition of international flows: risk sharing through foreign direct investment. *Journal of International Economics*, 61(2), pp. 353-383.
- Acemoglu, D., & Autor, D. 2012. "What does human capital do? A review of Goldin and Katz's *The race between education and technology*." NBER Working Paper No. 17820.
- Becker, G.S., 1964. *Human capital: A theoretical and empirical analysis, with special reference to education*. New York: NBER.
- Cosar, A.K. 2011. "Human capital, technology adoption and development." *The B.E. Journal of Macroeconomics*, 11(1), Article 5.
- Goldin, C. & Katz, L., 2008. *The race between education and technology*. Cambridge, MA: Harvard University Press.
- Mankiw, N. G., Romer, D., & Weil, D.N. 1992. "A contribution to the empirics of economic growth." *The Quarterly Journal of Economics* 107 (2): 407–437.
- MASHT. 2013. *Treguesit e Arsimit në Kosovë 2013*. Pristinë: MASHT.
- Nelson, R.R & Phelps, E.S. 1966. "Investment in humans, technological diffusion and economic growth. " *American Economic Review*, 56(2), pp. 69-75.
- Romer, P.M. 1990. "Endogenous technological change." *The Journal of Political Economy*, 98(5), pp. S71-S102.
- Riinvest. Vite të ndryshme. *SME Survey 2008*. Pristina: Riinvest Institute.
- Riinvest. 2011. *Policy Brief: Private Sector Development*. Pristina: Riinvest Institute and FES.
- Rizvanolli, A. 2012. *Human Capital and FDI: Evidence from European Transition Economies*. Staffordshire University: Unpublished PhD thesis.

SEECEL. 2013. "Training needs analysis for SMEs: Western Balkans and Turkey's Experience." Zagreb: SEEEL.

Suutari, V. & Riusala, K. 2000. "Operating in 'economies in transition' – Adjustment and management issues faced by Finnish expatriate managers in CEE. " *Finnish Journal of Business Economics*, 49(4), pp. 87-107.

UNECE, 2001. *Economic survey of Europe 2001 No. 1*. Geneva: United Nations.

Arben Mustafa* dhe Sokol Havolli**

RRJEDHA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

HYRJE

Rëndësia e investimeve të huaja direkte (IHD) për ekonominë e një vendi është e shumanshme. Ato mund të paraqiten në formë të investimeve në projekte të reja investuese (të njohura edhe si ‘greenfield’), por edhe në formë të bashkimit ose shkrirjes me ndërmarrje ekzistuese në vend. Të dy këto forma të investimeve mundësojnë shtimin direkt të stokut të kapitalit, që paraqet parakushtin kryesor për zhvillimin ekonomik të një vendi. Përveç shtimit të stokut të kapitalit fizik, rrjedha e investimeve të huaja është shumë e rëndësishme edhe për ngritjen e kapitalit human, duke qenë se investimet e huaja sjellin me vete edhe njohuri të avancuara për zhvillimin e afarizmit.

Duket i pasur parasysh rrethanat ekonomike në Kosovë, të gjitha këto aspekte të përfitimeve nga investimet e huaja direkte paraqiten si shumë të rëndësishme për ekonominë tonë. Së pari, sfidat kryesore të ekonomisë së vendit vazhdojnë të jenë shkalla e lartë e papunësisë dhe deficitit i lartë tregtar. Të dy këto probleme makroekonomike si shkaktar kryesor kanë mungesën e aktivitetit prodhues brenda ekonomisë së vendit. Rritja e veprimtarisë prodhuese kërkon

* Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

** Qeveria e Kosovës


investime të reja, ndërsa kapacitetet e ekonomisë vendore për të gjeneruar këto investime po paraqiten të mangëta dhe, rrjedhimisht, parashtrajnë nevojën për investime të huaja direkte. Së dyti, mundësitë për rritjen e ndërmarrjeve ekzistuese në Kosovë janë të kufizuara në financimin nga kapitali vetanak dhe financimi përmes kreditimit bankar, përderisa segmentet tjera të tregut të kapitalit në vend vazhdojnë të jenë mjaft të pazhvilluara. Në këtë kontekst investimet e huaja direkte paraqesin një mundësi shumë të mirë edhe për rritjen e mëtutjeshme të ndërmarrjeve ekzistuese dhe, për më tepër, mundësojnë një qasje më të mirë për plasimin e produkteve tona në tregjet e jashtme. Së treti, përveç nevojës për rritje të prodhimit, përmirësimi i bilancit tregtar të Kosovës kërkon edhe rritje të produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së prodhuesve vendorë, aspekte këto që mund të përmirësohen dukshëm duke adoptuar njohuritë e sjella nga investitorët e huaj. Prandaj rrjedha e investimeve direkte në vend duhet të trajtohet me një vëmendje të madhe nga ana e politikëbërësve dhe të konsiderohet si një ndër indikatorët më të rëndësishëm për monitorimin e performancës së ekonomisë së vendit.

RRJEDHA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

Shuma më e madhe investimeve të huaja direkte në Kosovë u regjistrua në vitin 2007, kur gjithsej shuma e IHD-ve arriti në 440.7 milion euro (Figura 1). Megjithatë, këto investime kryesisht kishin karakter të njëhershëm, meqë lidheshin me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore si dhe me licencimin e telefonisë së dytë mobile në Kosovë. Pas kësaj periudhe, me zvogëlimin e aktivitetit të privatizimit, por edhe si pasojë e krizës ekonomike globale, investimet e huaja direkte kryesisht ndoqën një trend rënës, përveç viteve 2010 dhe 2011 kur u evidentua rritje e IHD-ve. Vlera më e ulët e IHD-ve u regjistrua në vitin 2014. Gjatë këtij viti vlera e investimeve të huaja që hynë në Kosovë ishte më e ulët krahasuar me vitet paraprake dhe, në të njëjtën kohë, disa nga kompanitë e huaja që operojnë në Kosovë

shpërndanë dividendë në vlerë më të madhe se sa fitimet e tyre për periudhën përkatëse dhe po ashtu disa kompani të huaja u blenë nga pronarë vendorë, duke ndikuar kështu në zvogëlimin e kapitalit të huaj në ekonominë e vendit. Në vitin 2014 vlera neto e IHD-ve në Kosovë ishte 151.2 milion euro, krahasuar me vlerën prej 280.2 milion euro në vitin 2013. Sidoqoftë, gjatë vitit 2015 vërehet një rritje e konsiderueshme e IHD-ve, ku vetëm gjatë nëntë muajve të parë të këtij viti vlera e IHD-ve ka arritur në 261 milion euro. Kjo rritje kryesisht ka rezultuar nga rritja e investimeve të huaja në sektorin e patundshmërive dhe në sektorin financiar.

Figura 1. Vlera e IHD neto në Kosovë dhe të hyrat nga privatizimi




Burimi: BQK (2015)

Shënim: Vlera e të hyrave nga privatizimi paraqet ndryshimin e stokut vjetor të depozitave të AKP-së në BQK.

Shikuar sipas sektorëve, investimet e huaja direkte fillimisht kishin një përqendrim më të madh në sektorin e industrisë, investime këto që lidhen kryesisht me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore. Me ngadalësimin e procesit të privatizimit në vitet vijuese, u ngadalësua edhe rrjedha e investimeve të huaja drejt sektorit të industrisë, për t'u zëvendësuar nga një rrjedhë më e madhe e investimeve të huaja drejt sektorit të patundshmërisë, që paraqet sektorin me rritjen më të madhe të IHD-ve në katër vitet e pranuar (Figura 2). Ky ndryshim në strukturën e investimeve të huaja direkte flet për zhvendosje të investimeve prej një sektori më produktiv të ekonomisë, me potencial për të ndihmuar përmirësimin e aspekteve kyçe të ekonomisë së vendit, siç janë papunësia dhe deficitit tregtar, drejt një sektori i cili, megjithëse i sjellë ekonomisë së vendit të hyra nga jashtë, ka potencial më të kufizuar për të mbështetur zhvillimin ekonomik të vendit.

Figura 2. Rrjedha e IHD-ve në sektorë të zgjedhur të ekonomisë




Burimi: BQK (2015)

Pjesëmarrja më e lartë e sektorit të industrisë në strukturën e përgjithshme të IHD-ve u regjistrua gjatë viteve 2007-2010, kur norma mesatare e pjesëmarrjes ishte 19.6 për qind. Në vitet pasuese pjesëmarrja e industrisë në gjithsej investimet e huaja shënoi rënie të vazhdueshme. Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015 sektori i industrisë u përfaqësua me vetëm 3.4 për qind në gjithsej vlerën e IHD-ve në Kosovë. Në anën tjetër, përdërisa në vitin 2007 investimet e huaja në patundshmëri përfaqësonin vetëm 7 për qind të gjithsej IHD-ve në Kosovë, në katër vitet e fundit patundshmëria është sektori që dukshëm dominon strukturën e IHD-ve në Kosovë me një normë mesatare të pjesëmarrjes në gjithsej IHD-të prej rreth 60 për qind. Investimet e huaja direkte në patundshmëri kryesisht kanë të bëjnë me blerjen e apartamenteve të banimit në Kosovë nga diaspora kosovare.

Gjatë kësaj periudhe rritje kanë shënuar edhe IHD-të në sektorin e ndërtimtarisë, që në shtator 2015 përfaqësuan 19 për qind të gjithsej IHD-ve, përdërisa në vitin 2007 pjesëmarrja e tyre ishte 5.2 për qind (Figura 3). Trendi i investimeve të huaja në sektorin e ndërtimtarisë kryesisht është i lidhur me investimet në infrastrukturën rrugore, siç është rasti i autostradës Kosovë - Shqipëri, por një pjesë e konsiderueshme e tyre lidhet edhe me investimet në objekte banimi.

Figura 2. Struktura e IHD-ve sipas sektorëve



Burimi: BQK (2015)


Ndërsa sektori që ka treguar stabilitetin më të lartë për sa i përket IHD-ve është sektori financiar, i cili në vazhdimësi ka qenë ndër sektorët më tërheqës për investimet e huaja. Që nga viti 2007 mesatarisht rreth 18.1 për qind e gjithsej investimeve të huaja direkte në Kosovë janë përbërë nga investimet në sektorin financiar. Një pjesë e konsiderueshme e investimeve në sektorin financiar (rreth 30 për qind e IHD-ve në këtë sektor) përbëhet nga fitimi i riinvestuar i institucioneve të huaja financiare që operojnë në Kosovë.

Një sektor tjetër me pjesëmarrje relativisht të qëndrueshme në gjithsej strukturën e investimeve të huaja në Kosovë është sektori i transportit dhe komunikimit, i cili që nga viti 2007 ka marrë pjesë me mesatarisht 10 për qind në strukturën e përgjithshme të IHD-ve në Kosovë. Investimet më të mëdha në këtë sektor u regjistruan në vitin 2007 dhe lidheshin kryesisht me hyrjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë. Në vitin 2007 sektori i transportit dhe i telekomunikacionit përfaqësoi pjesën më të madhe të gjithsej IHD-ve në Kosovë (29 për qind e gjithsej IHD-ve).

Sektori me pjesëmarrjen më të ulët në gjithsej vlerën e IHD-ve në Kosovë në vazhdimësi ka qenë sektori i bujqësisë. Në vitin 2007 vetëm 1.8 për qind e IHD-ve kishte për destinim sektorin e bujqësisë, ndërsa në vitet e fundit pjesëmarrja e këtij sektori u zvogëlua edhe më tutje, duke rënë në 0.2 për qind në shtator 2015.

Origjina e investimeve të huaja direkte në Kosovë vazhdon të jetë kryesisht nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Megjithatë, përgjatë viteve ka pasur ndryshime për sa i përket shteteve prej nga vijnë investimet e huaja në Kosovë. Përderisa në vitin 2007 pjesa më e madhe e investimeve të huaja vinin nga Britania e Madhe, Sllovenia dhe Gjermania, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015 vendet si Zvicra, Austria, Turqia dhe Shqipëria paraqesin vendet prej nga vjen pjesa më e madhe investimeve të huaja në Kosovë.

Figura 2. Struktura e IHD-ve sipas shtetit të origjinës



Burimi: BQK (2015)

PËRFUNDIM

Rrjedha e investimeve të huaja direkte në Kosovë ka qenë e përcaktuar kryesisht nga zhvillimet specifike në sektorë të caktuar të ekonomisë, siç ishte licencimi i operatorit të dytë të telefonisë mobile, procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe ndërtimi i autostradës Kosovë - Shqipëri. Si rrjedhojë e kësaj, rrjedha e investimeve të huaja në Kosovë u karakterizua me luhatje mjaft të mëdha si në vlerën ashtu edhe në strukturën e investimeve të pranuar. Luhatjet më të mëdha u reflektuan te sektorët e industrisë dhe patundshmërisë. Përderisa fillimisht investimet e huaja direkte në sektorin e industrisë ishin mjaft të mëdha, ndërsa investimet në patundshmëri përfaqësonin një pjesë relativisht të vogël të gjithsej investimet e huaja direkte në Kosovë, në katër vitet e fundit investimet në patundshmëri dominojnë strukturën e investimeve të huaja, kurse investimet në sektorin e industrisë përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të gjithsej investimeve të huaja direkte në Kosovë. Duke pasur parasysh sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet ekonomia e vendit, siç janë papunësia dhe deficitet tregtar, paraqitet nevoja që të krijohen kushtet për investime më të mëdha në sektorët që sigurojnë nivel më të lartë prodhimi dhe punësimi.

Bejtush Kiçmari¹

PËRCAKTUESIT E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË VENDET E EVROPËS JUGLINDORE

HYRJE

Lidhur me rëndësinë e investimeve të huaja direkte (IHD) ekzistojnë argumente për dhe kundër, mirëpo pikëpamja konsensuale në literaturë dhe përpjekjet e qeverive për të tërhequr IHD-ve sugjerojnë se përfitimet tejkalojnë kostot e tyre. Efektet e IHD-ve, edhe pse janë konfirmuar pozitive në shumicën e studimeve, varen nga aftësia absorbuese e vendit pritës, siç janë: niveli i kapitalit njerëzor, niveli i infrastrukturës, zhvillimi financiar, institucional dhe politikat tregtare. Identifikimi i përcaktuesve të IHD-ve varet nga karakteristikat e shteteve, sektorëve dhe kompanive, ndërsa në literaturë madhësia e tregut, burimet natyrore, kostoja e ulët, afërsia gjeografike, si dhe stabiliteti makroekonomik paraqiten si faktorët kryesorë në tërheqjen e IHD-ve.

Pavarësisht rritjes së investimeve në vendete e Evropës Juglindore (EJL), mbeten dallime të mëdha në mes të këtij rajoni dhe ekonomive të tjera. Për më tepër, diferencat ndërmjet vendeve të EJL-së në tërheqjen e IHD-ve janë të theksuara, andaj qëllimi i këtij artikulli është që të hulumtojë përcaktuesit e IHD-ve në EJL, duke përdorur të dhëna panel për vitet 2000 – 2011. Në vijim të artikullit

* Pikëpamjet e paraqitura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

shtjellohet specifikimi i modelit, interpretimi i rezultateve dhe në fund janë të përmbledhura gjetjet kryesore.

MODELI DHE HIPOTEZAT

Modeli i përdorur është kombinim i përcaktuesve tradicionalë dhe të përcaktuesve të cilët janë identifikuar si të rëndësishëm për ekonominë në tranzicion, sepse është e pamundur që të shpjegohen motivet e IHD-ve në EJK duke u bazuar vetëm në një teori:

$$\text{LOGFDI}_{jt} = \beta_1 + \beta_2 \text{GDP}_{jt} + \beta_3 \text{RGDPG}_{jt} + \beta_4 \text{DIST}_j + \beta_5 \text{ULC}_{jt} + \beta_6 \text{COMF}_{jt} + \beta_7 \text{UNEMP}_{jt} + \beta_8 \text{OPEN}_{jt} + \beta_9 \text{PREV}_{jt} + \beta_{10} \text{SERV}_{jt} + \varepsilon_{jt}$$

ku, j paraqet vendin dhe t paraqet vitin.

LOGFDI nënkupton pranimet neto të IHD-ve në dollarë; GDP nënkupton prodhimin e brendshëm bruto në dollarë, i cili përfaqëson madhësinë e tregut; RGDPG nënkupton normën e rritjes së PBB-së reale dhe përfaqëson rritjen dhe potencialin e tregut; DIST është distanca në mes të kryeqytetit të vendit j dhe Brukselit; ULC nënkupton koston e punës; COMF nënkupton lehtësirat në komunikim. Si përcaktuesit specifikë janë përfshirë: UNEMP që nënkupton papunësisë dhe përfaqëson jostabilitetin ekonomik; OPEN paraqet hapjen ndaj vendeve tjera; PREV nënkupton të ardhurat nga privatizimi dhe SERV nënkupton sektorin e shërbimeve.

Madhësia e tregut në shumicën e studimeve është argumentuar si përcaktues i rëndësishëm i IHD-ve, sidomos i IHD-ve që kërkojnë treg për shitjen e prodhimeve apo shërbimeve, sepse tregu më i madh ofron mundësi për shfrytëzimin e ekonomisë së shkallës si dhe të diversifikimit ekonomik. Prandaj ky variabël pritet të ketë ndikim të rëndësishëm pozitiv. Poashtu rritja dhe potenciali i tregut pritet të jetë i lidhur pozitivisht me IHD-të, sepse shkalla e shpejtë e rritjes

ekonomike ka tendencë që të tërheqë më shumë IHD. Ndërlidhja midis IHD-ve dhe distancës, por edhe kostos së punës pritet të jetë negative, sepse shpenzimet më të larta të inputeve ndikojnë në rënien e rentabilitetit dhe rrjedhimisht edhe në tërheqjen më të vogël të IHD-ve. Lehtësirat në komunikim, e cila është variabla e fundit tradicionale e përfshirë në model, pritet të kenë ndikim pozitiv në tërheqjen e IHD-ve, sepse lehtësirat në komunikim janë kusht i domosdoshëm për operimin e kompanive shumëkombëshe.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë të përcaktuesve të IHD-ve dhe për të adresuar disa nga kufizimet e mundshme janë përfshirë edhe disa përcaktues specifikë. Jostabiliteti ekonomik pritet të ndikojë negativisht, sepse jostabiliteti krijon pasiguri në mjedisin e biznesit. Hapja tregtare tregon se sa është një vend i integruar në ekonominë globale, kështu që hapja e ekonomisë pritet të ndikojë pozitivisht, veçanërisht të IHD-të e orientuara drejt eksportit, por kjo mund të ndikojë negativisht nëse IHD-të kanë për synim zëvendësimin e importit. Privatizimi pritet të ndikojë pozitivisht në tërheqjen e IHD-ve, sepse, sipas UNCTAD (2007) shumica e IHD-ve në EJL ishin të nxitura nga privatizimi i ndërmarreve shtetërore. Për më tepër, sipas Škuflić-it dhe Botrić-it (2006), IHD-të në vendet e EJL-së ishin të orientuara kryesisht në sektorin e shërbimeve. Për të matur këtë efekt është përfshirë edhe variabla për shërbime e cila pritet të ndikojë pozitivisht në tërheqjen e IHD-ve.

INTERPRETIMI I REZULTATEVE

Modeli i përdorur rezulton të jetë i specifikuar mirë pasi që rëndësia e përgjithshme statistikore qëndron në nivelin prej 1 për qind, por edhe fuqia shpjeguese është mjaft e lartë:

Përcaktuesit e IHD-ve, modeli Random Effect Devijimi standard është paraqitur në kllapa.

Simbolet ***, **, dhe * paraqesin rëndësinë statistikore në nivelin prej $p < 0.01$, $p < 0.05$ dhe $p < 0.1$ për qind përkatësisht.

PBB-ja në të gjitha specifikimet ka shenjë pozitive dhe ka koeficient statistikisht të rëndësishëm. Kjo është në përputhje me hipotezën tonë se tregu më i madh tërheq më shumë IHD, duke ofruar kështu mbështetje për IHD-të që kërkojnë treg. Ky koeficient sugjeron se rritja prej 1 miliard dollarë e PBB-së do të rezultonte në mesatarisht 3.0 për qind rritje në pranimet e IHD-ve, duke mbajtur të gjitha variablat e tjera konstante. Po ashtu norma e rritjes së PBB-së reale ka ndikim të rëndësishëm pozitiv dhe sipas modelit rritja prej 1 pikë përqindje e PBB-së do rezultonte në mesatarisht 5.0 për qind rritje në pranimet e IHD-ve.

Variable e varur = logaritmi natyral i pranimëve neto të IHD-ve (LOGFDI)

Variablat e pavarura	-1	-2	-3	-4
	Variablat tradicionale	Variablat specifike	Specifikimi i plotë	Specifikimi i plotë pa UNEMP dhe SERV
<i>Constant</i>	20.15***	14.70***	18.84***	21.29***
<i>GDP</i>	-1.193	-2.19	-2.609	-1.284
<i>RGDPG</i>	0.01***		0.03***	0.04***
<i>DIST</i>	-0.002		-0.006	-0.004
<i>ULC</i>	0.06**		0.05**	0.06**
<i>COMFA</i>	-0.024		-0.027	-0.026
<i>UNEMP</i>	0		0	-0.001*
<i>OPEN</i>	0		-0.001	-0.001
<i>PREV</i>	-0.23***		-0.05	-0.19***
<i>SERV</i>	-0.054		-0.078	-0.049
<i>R²</i>	0.058***		0.02	0.01
Nr. i observimeve	-0.01		-0.014	-0.014
		-0.09***	-0.04**	
		-0.02	-0.021	
		0.04***	0.01*	0.01*
		-0.008	-0.008	-0.006
		0.03*	0.04**	0.05***
		-0.021	-0.014	-0.014
		0.08**	0.02	
		-0.037	-0.027	
	0.67	0.67	0.86	0.85
	91	59	59	59

Distanca e cila është përfshirë me qëllim që të shikohet nëse ka ndikim në tërheqjen e IHD-ve është vërtetuar e parëndësishme për të ndikuar në vendimin e investitorëve për të investuar në vendet e EJL-së. Kostoja për njësi pune, e cila është përdorur për të sqaruar nëse motivi i IHD-ve në vendet e EJL-së është rritja e efikasitetit, është vërtetuar po ashtu e parëndësishme në kombinim me përcaktuesit specifikë (specifikimi i tretë). Arsyeimi se pse ky koeficient është i parëndësishëm mund të jetë se pagat e ulëta nuk mund të jenë tërheqësi kryesor i investimeve pasi që IHD-të në vendet e EJL-së janë të koncentruar në sektorin e shërbimeve, ku kërkohen punëtorë më të kualifikuar. Arsyeim tjetër mund të jetë fakti se periudha e analizuar nuk përfshinë fazën e parë të tranzicionit, ku fuqia e lirë punëtore është në mesin e përcaktuesve kryesor të IHD-ve, por pasi që vendi tërheq më shumë IHD rëndësia e këtij faktori zvogëlohet. Edhe variabla e fundit tradicionale, lehtësirat në komunikim, e cila është menduar të jetë kusht i domosdoshëm për investitorët, është vërtetuar e parëndësishme në kombinim me përcaktuesit specifikë të vendeve në tranzicion.

Së fundi, janë paraqitur përcaktuesit specifikë të IHD-ve, të cilët janë të rëndësishëm pavarësisht nëse IHD-të janë të orientuara drejt zgjerimit të tregut, resurseve natyrore apo rritjes së efikasitetit. Në përgjithësi këta përcaktues duket të jenë të rëndësishëm në tërheqjen investimeve në ekonomitë e EJL-së, sepse të gjitha variablat janë të rëndësishme dhe kanë shenjat e pritura.

Jostabiliteti ekonomik ka ndikim të rëndësishëm negative dhe është në përputhje me hipotezën tonë se jostabiliteti i lartë dhe i vazhdueshëm ekonomik krijon pasiguri në mjedisin e biznesit. Më saktësisht, 1 pikë përqindje e rritjes në normën e papunësisë do të rezultojë në mesatarisht rreth 4 për qind më pak pranime të IHD-ve, duke mbajtur të gjitha variablat tjera konstante.

Hapja ndaj vendeve të tjera ka ndikim të rëndësishëm pozitiv në të gjitha specifikimet dhe është në përputhje me hipotezën tonë e cila

sugjeron se hapja e ekonomisë duhet të jetë e lidhur pozitivisht me IHD-të sidomos në rastin e investimeve të huaja të orientuara nga eksporti. Interpretimi i këtij koeficienti sugjeron se rritja për 1 pikë përqindje e pjesëmarrjes së importit dhe eksportit në PBB do të ndikonte në mesatarisht 1 për qind rritje në pranimet e IHD-ve. Ky konstatim shpjegohet nga fakti se tregtia dhe investimet plotësojnë njëra-tjetrën. Bevan dhe Estrin (2000) argumentojnë se vendet që kanë më shumë liberalizim të tregtisë kanë tendencë për të eksportuar më shumë dhe kjo situatë paraqet një mundësi tërheqëse për firmat e huaja.

Privatizimi është një përcaktues i rëndësishëm për ekonominë në tranzicion, sepse krijon mundësi për investitorët. Kjo variabël është e rëndësishëm dhe kanë shenjat e pritshme pozitive në të gjitha specifikimet e modelit. Për më tepër, rëndësia e këtij koeficienti rritet në kombinim me përcaktuesit tradicionalë duke mbështetur faktin se shumica e IHD-ve në EJL ishin të nxitura nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore. Ky konstatim është në përputhje me hipotezën se privatizimi ka një efekt të fuqishëm pozitiv në tërheqjen e IHD-ve. Më saktësisht, rritja prej 1 pikë përqindje në të ardhurat nga privatizimi si përqindje e PBB-së shpie në mesatarisht 4 për qind rritje të IHD-ve.

Fakti që sektori i shërbimeve luan një rol të rëndësishëm në tërheqjen e IHD-ve në vendet e EJL-së është mbështetur nga rezultatet tona vetëm në specifikimin e dytë, ku koeficienti i kësaj variabël është statistikiisht i rëndësishëm në nivelin e rëndësisë prej 5 për qind. Në specifikimin e tretë ky variabël ka koeficient statistikiisht të parëndësishëm për shkak të korrelacionit me DIST dhe COMFA. Prandaj, bazuar në modelin tonë, nuk kemi informacion të mjaftueshëm për të sugjeruar se sektori i shërbimeve është më atraktiv se sektorët e tjerë.

PËRMBLEDHJE

Modeli i përcaktuar me të dhëna panel për vitet 2000-2011 sugjeron se madhësia e tregut dhe perspektiva e tij janë përcaktuesit më të rëndësishëm të IHD-ve në EJK, prandaj duket se tregu është një motiv i rëndësishëm për hyrjet e IHD-ve. Në ana tjetër vëzhgimi i rëndësisë së efikasitetit është problematik pasi që ndërlidhja ndërmjet IHD-ve dhe kostos për njësi pune rezulton të jetë e parëndësishme për arsye se IHD-të në EJK janë të drejtuara kryesisht drejt sektorit të shërbimeve, i cili kërkon punë më të kualifikuar sesa sektori i prodhimit, si dhe periudha e analizuar në këtë studim nuk mbulon fazën e parë të tranzicionit, ku fuqia e lirë punëtore është ndër përcaktuesit më të rëndësishëm të IHD-ve. Edhe distanca dhe lehtësirat në komunikim, si përcaktues tradicionalë, kanë rezultuar të parëndësishme në tërheqjen e IHD-ve.

Variablat specifike duhet të kenë efekt të njëjtë si ndaj IHD-ve që kanë për synim zgjerimin e tregut, ashtu edhe ndaj atyre që kanë për synim rritjen e efikasitetit. Në përputhje me këtë argument, analiza tregon se këto variabla nuk ndryshojnë shumë në kombinim me variablat tradicionale. Më konkretisht, jo stabiliteti ekonomik u konstatua të ketë efekt të rëndësishëm negativ në tërheqjen e IHD-ve. Për më tepër, janë konfirmuar rezultatet e analizave të mëparshme se shkalla e hapjes apo e integritit me pjesën tjetër të botës luan një rol të rëndësishëm në tërheqjen e IHD-ve. Ky hulumtim tregon se hyrjet e IHD-ve në ekonominë e EJK-së mund të shpjegohen nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore pasi që rëndësia e privatizimit rritet në kombinim me përcaktuesit tradicionalë të IHD-ve. Në kontrast me dëshmitë e disa burimeve që IHD-të në vendet e EJK-së janë të drejtuara kryesisht drejt sektorit të shërbimeve, ky studim nuk ka ofruar informacion të mjaftueshëm për të sugjeruar se sektori i shërbimeve është më tërheqës se sa sektorët e tjerë.

Duhet të theksohet se faktorë tjerë politikë, shoqërorë dhe institucionalë, si: angazhimi për sundimin e ligjit dhe qeverisjes së mirë, cilësia e fuqisë punëtore, progresi në reformat institucionale, klima biznesore, etj. nuk janë analizuar në këtë studim. Kjo nuk do të thotë se këta faktorë nuk kanë ndikim në flukset hyrëse të IHD-ve. Kjo është thjeshtë për shkak të vështirësive në qasjen në të dhëna dhe mosdisponueshmëria e të dhënave përkatëse. Gjetjet në këtë hulumtim sugjerojnë se veprimet e qeverisë nuk ka gjasa të jenë në gjendje të tërheqin investime që kanë për synim zgjerimin e tregut. Në vend të kësaj qeveritë duhet të sigurohen që të shënojnë progres në procesin e tranzicionit. Për më tepër, politikat që synojnë liberalizimin e tregtisë janë të rëndësishme në nxitjen e integritit ekonomik dhe në këtë mënyrë mund të ofrojnë një treg me numër më të madh të banorëve. Së fundi, organizimi i duhur i procesit të privatizimit, si dhe rritja e stabilitetit ekonomik janë kushte të domosdoshme për tërheqjen e më shumë IHD-ve.

REFERENCAT

- Bevan, A. and Estrin, S. (2004), *The determinants of foreign direct investment into European transition economies*, ELSEVIER, Journal of Comparative Economics.
- Blomström, M. and Kokko, A. (2003), *The economics of foreign direct investment incentive*, Working Paper Number 168.
- Campos, N. and Kinoshita, Y. (2003), *Why Does FDI Go Where it Goes? New Evidence from the Transition Economies*, IMF Working Paper, WP/03/228.
- Christie, E. (2003), *Foreign Direct Investment in Southeast Europe*, wiiw Working Papers, No.24.
- Damijan, J. et al. (2001), “*The role of FDI, R&D accumulation and trade in transferring technology to transition countries: Evidence from panel data for eight transition countries*”, Institute for Economic Research, Working paper No.10, 2001.
- Demekas, D., Harvath, B., Ribakova, E., and Wu, L. (2005), *Foreign Direct Investment in Southeastern Europe: How (and How Much) Can Policies Help?*, IMF Working Paper, European Department, WP/05/110.
- Di Mauro, F. (2000), *The Impact of Economic Integration on FDI and Exports: A Gravity Approach*, CEPS Working Document No. 156.
- Fabry, N. and Zeghni, S. (2006), *FDI in the New European Neighbours of Southern Europe: a quest of institutions-based attractiveness*, MPRA Paper No. 1109.
- Garibaldi, P., Mora, N., Sahay, R., and Zettelmeyer, J. (2001), *What Moves Capital to Transition Economies?*, IMF Staff Papers, Vol. 48, Special Issue.

- Holland, D. and Pain, N. (1998), *The Diffusion of Innovations in Central and Eastern Europe: A Study of The Determinants and Impact of Foreign Direct Investment*, National Institute of Economic and Social Research.
- Janicki, H. and Wunnava, Ph. (2004), *Determinants of foreign direct investment: empirical evidence from EU accession candidates*. Applied Economics, No. 36, 505-509.
- Jonson, A. (2006), *FDI inflow to the Transition Economies in Eastern Europe: Magnitude and Determinants*, CESIS Electronic Working Paper Series, Paper No. 59.
- Kinoshita, Y. and Campos, N. (2004), *Estimating the Determinants of Foreign Direct Investment Inflows: How Important are Sampling and Omitted Variable Biases?* Bank of Finland, BOFIT – Institute for Economies in Transition, Discussion Papers. No.10.
- Moosa, A. Imad (2002), *Foreign Direct Investment – Theory, evidence and practice*, PALGRAVE.
- Škuflić, L. and Botrić, V. (2006), *Foreign Direct Investment in Southeast European Countries: The Role of Service Sector*. Eastern European Economics, Vol. 44, No. 5, pp. 72-90.
- UNCTAD (2007), *World Investment Report: Transnational Corporation, Extractive Industries and Development*. New York and Geneva, 2007.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË
2016

Botues:
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:
Shefqet Riza

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 6.69 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

330.322(4/9: 496.51)
338.2(496.51)

Investimet e huaja direkte në Kosovë : Tryezë shkencore 22 dhjetor 2015 / Redaktor Jusuf Bajraktari. – Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës : Seksioni i Shkencave Shoqërore, 2016. – 105 f. : ilustr. ; 24 cm

Titulli dhe teksti paralel në gjuhën shqipe dhe angleze.

1. Bajraktari, Jusuf

ISBN 978-9951-615-61-7